

# Dukagjini "Nderi i Kombit"



# Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 251, Shtator 2024


Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

## Sali Mani - Pasaporta Kulturore e trevës sonë, Malësisë së Madhe, në mbare trojet Shqiptare dhe kudo në Diasporë

Me veprimtarinë e gjithëdijshëm të 20 Shtatorit 2024 të titulluar "Akademi Përkujtimore" si dhe pjesëmarrja e shumtë, përsëndetjet e referimet nga më të vlerata të personaliteteve të artit e kulturës, prania e drejtuesve vendorë të Malësisë së Madhe e të Qarkut Shkodër, të mediave lokale, rajonale e kombëtare si dhe financimi e impenjimi maksimal i "Miqve të Sali Manit në Amerikë", me në krye të nderuarit bashkëmalësorë Luigj Gjokaj e Ndue Gjekaj, që e vendosën Këngëtarin e Madh, Sali Mani përjetësisht në Altarin e Kulturës së Kombit Shqiptare, aty ku janë e do mbetën gjithmonë korifenjtë që dhanë në çdo kohë gjithçka për trojet tona e më gjërë.

Ishte e do mbetët një datë historike jo vetëm për trevën tone, Malësi e Madhe, por edhe për mbarë Viset Shqiptare dhe do nëpër botë, ku jetojnë e punojnë shqiptarë...

5



## Në ditëlindjen e 70-të të Mark Palnikajt, nderohet nga Papa Françesku!

Në një botë ku shpesh historia shkruhet dhe ridizajnohet, Mark Palnikaj është aty si një dritë që shndrin fort duke kërkuar të vërtetat që janë fshehur thellë në arkivat e kohës. Sot, ai feston 70-vjetorin e lindjes.

Një ditë që shënon jo vetëm një përvjetor personal, por edhe një moment feste për të gjithë ata, miqtë e tij të shumtë.

Me një pasion të thellë për kërkimin e së vërtetës, Palnikaj është nderuar edhe nga Papa Françesku, një njohje që thekson rëndësinë e kontributit të tij për njohjen e identitetit tonë kombëtar.

Kryeinxhinieri, që e nisi jetën në shërbim të bashkësisë, ka sfiduar falsikimet dhe mitet që e rrethojnë historinë tonë.

Ai nuk ka ditur të pushojë, përkundrazi edhe në ato pak orë të lira ka qenë duke hulumtuar për të qenë një hap drejt zbardhjes të së vërtetës.

## Shoqata Atdhetare "Dukagjini" organizon veprimtarinë "Misioni i mësuesit"

Me datën 14 shtator 2024, ditë e shtune, në ora 10:30 Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në mjediset e bibliotekës "Marin Barleti" në Shkodër organizoi veprimtarinë me temë "Misioni i mësuesit". Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie ishte të sensibilizojmë misionin e mësuesit, se mësuesi është prindër i dyte për nxënësin, është ai që i jep shkollim nxënësit, djalit po vajzës për jetën e tij, se vetëm shkollimi i jep atij mundësinë të eci në jetë.

Të pranishëm ishin nenkryetarja e Bashkise Shkodër, zonja Teuta Qyteza, zonja Briselda Kadia, Drejtoresha e drejtorisë së arsimit në Shkodër, zoti Edmond Terthorja, Administratori i Universitetit Bujqësor Tiranë.

Kjo veprimtari erdhi nen kujdesin...

2



# Shoqata Atdhetare “Dukagjini” organizon veprimtarinë “Misioni i mësuesit”



**Klodjana Serraj,**  
drejtuesja e veprimtarisë

Me datën 14 shtator 2024, ditë e shtune, në ora 10:30 Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në mjediset e bibliotekës “Marin Barleti” në Shkodër organizoi veprimtarinë me temë “Misioni i mësuesit”. Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie ishte të sensibilizojmë misionin e mësuesit, se mësuesi është prindër i dytë për nxënësin, është ai që i jep shkollim nxënësit, djalit po vajzës për jetën e tij, se vetëm shkollimi i jep atij mundësinë të eci në jetë.

Të pranishëm ishin nenkryetarja e Bashkisë Shkodër, zonja Teuta Qyteza, zonja Briselda Kadia, Drejtoresha e drejtorisë së arsimit në Shkodër, zoti Edmond Terthorja, Administrator i Universitetit Bujqësor Tiranë.

Kjo veprimtari erdhi nën kujdesin e veçante të Kryesise së Shoqates Atdhetare “Dukagjini”.

Veprimtaria u moderua nga redaktroja e gazetës “Dukagjini” znj. Klodjana Serraj.

Gjithashtu veprimtaria erdhi nga bashkëpunim me shkollat e Qarkut Shkodër, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës 9-vjeçare Shkolla 9 vjeçare në Pult-Shosh, Shkolla 9 vjeçare në Prekal, Shkolla 9 vjeçare në Shllak e Temal, Shkolla 9 vjeçare “Vasil Shanto”, në Vrakë, Shkolla 9 vjeçare “Tring Smajlja” në Grude të Re, Shkolla 9 vjeçare në Bardhaj, Shkolla 9 vjeçare “Ndre Mjeda”, në Shkodër, Shkolla 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, në Shkodër, Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”, Shkolla e mesme profesionale “Arben Broci”, në Shkodër, Shkolla e mesme “Oso Kuka”, Shkolla 9 vjeçare “Cor Jesu”, në Shkodër, Shkolla 9 vjeçare në Torovicë, Shkolla e edukimit në Lezhë, Shkolla 9 vjeçare në Gruemirë, Shkolla 9 vjeçare në Melgushë dhe Shkolla 9 vjeçare në Sterbeq.

Veprimtaria filloi me fjalën e zotit Kole Çardakut, një nga veteranet e mësuesit, në Dukagjin, por dhe N/kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”...

Në vijim opinione dhane:

Prele Milani (studiuuesi, historian e publicist) N/kryetari i Shoqates Atdhetare “Dukagjini”;

Zj. Briselda Kadia, drejtoreshë e Zyrës Vendore të Arsimit, në Bashkinë Shkodër, ku theksoi rëndësinë e rolit të mësuesit, sfidat që hasen cdo ditë nga mësuesit dhe nxënësit në përshtatje me ndryshimin e brezave. Vlerësoi mjaft rolin e Shoqates

Atdhetare “Dukagjini” për bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër si dhe theksoi rolin që ka luftuar kjo shoqatë në lartësimin e figurave domethënëse si ajo mësuesit, të promovimit të rolit të tij në transmetimin e dijes.

Më pas fjalën përshëndetëse e mori z. Nesti Kiri, mësuesi i shkollës industriale “Arben Broci”, një inxhinier, i cili ka ndryshuar kulturën e mësimdhënies në arsimin profesional, duke e bërë të pëlqeshëm nga studentet që duan të ndjekin këtë sektor.

Në vijim veprimtaria u fokusua në dhëniën e titujve të nderit për mësuesit, për të cilën Kryesia e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me vendim nr. 268, date 15 shkurt 2022 vendosi: Të krijohet simboli i nderimit “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me të cilën do të nderohen mësuesit, nxënësit e studentet dhe ky titull jepet me vendim të veçante të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

#### Kush është Kushë Micja?

Për këtë figurë kanë studiuar e shkruar plote personalitete të fushës së shkollimit dhe në mes tyre Hamdi Bushati, Simon Rrota, Njazi Kazazi, Gjush Sheldia, Ludovik Shllaku, gazeta e Diasporës, Lu-

igi Shyti e të tjerë e të tjerë dhe të gjithë janë në një mendim, se Kushë Micja ishte e para femër, që hapi shkollën femërore në vitin 1859, në qytetin e Shkodrës.

Prandaj, me vendim të veçante nr. 288, date 5 shtator 2024, në bashkëpunim me drejtorinë e shkollave bashkëpunuese, ju jepet titulli

“Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, me motivacion: “Për kontributin tuaj të veçantë shumëvjeçare në edukimin e brezave me dije, kulturë dhe dashuri për vendlindjen. Ajo që ju keni dhënë qëndron dhe do qëndrojë në themelin e Kombit si investimi më madhorë për një shoqëri të emancipuar e bashkëkohore! Për bashkëpunimin të vijueshëm me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, në realizimin e misionit të saj”;

#### mësuesve:

##### Shkolla 9 vjeçare në Pult-Shosh

-Gjelosh Kole Vata, shkolla Plan, datëlindja 5 mars 1968

-Ndok Gjelosh Leka, shkolla Gjuraj, datëlindja 11 nëntor 1958

- Ndue Mark Kamdaçi, Kir

-Gjeline Pashko Demaj, Bruçaj, datëlindja 15 korrik 1969

-Zef Marash Podi, Ndreaj

-Zojë Gjoke Vuksani, Shoshi, pensioni-

ste

##### Shkolla 9 vjeçare në Prekal

-Vate Doçaj, fshati Nicaç, Shalë

##### Shkolla 8 vjeçare në Shllak e Temal

-Nikë Kola

##### Shkolla 9 vjeçare “Vasil Shanto”, në Vrakë

-Vitore Shqarri,

-Vera Gjeloshi.

##### Shkolla 9 vjeçare “Tring Smajlja” në Grude të Re

-Gjyete Mark Lera, mësuese e ciklit të ultë, pensioniste ...

##### Shkolla 9 vjeçare në Bardhaj

-Kolë Larushku, nga fshati Toplanë

-Roza Toka - Cara

##### Shkolla 9 vjeçare “Ndre Mjeda”, në Shkodër

-Ermir Pal Lera, i datëlindjes 2 mars 1989, në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan i krahinës së Pultit, mësues në shkollën 9 vjeçare “Ndre Mjeda”, nga viti 2014 - 2023, për edukimin fizike ... pas vdekjes aksidentale ....

##### Shkolla 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”, në Shkodër

-Dukate Bregu

##### Shkolla 9-vjeçare “Martin Camaj”

-Elena Marku,

-Gjon Podia.

##### Shkolla e mesme profesionale “Arben Broci”, në Shkodër

-Shuke Marku,

-Nesti Kiri.

##### Shkolla e mesme “Oso Kuka”

-Diana Ndreu ....

##### Shkolla 9 vjeçare “Cor Jesu”, në Shkodër

-Rita Guri, drejtoreshë e shkollës 9 vjeçare “Cor Jesu”, në Shkodër

##### Shkolla 9 vjeçare në Torovicë,

-Lula Bregu - Prroni

##### Shkolla e edukimit në Lezhë

-Shpresa Ftoni, edukatore

##### Shkolla 9 vjeçare në Gruemirë

-Tringa Shytani, mësuese në Gruemirë

##### Shkolla 9 vjeçare në Melgushë

-Djella Lin Vuksani

##### Shkolla 9 vjeçare në Sterbeq

-Martin Gjoni

Në SHBA

-Vjollca Kapaj (Funiçi) mësuese, sot në SHBA

-Marie Bregu, mësuese, bashkëshortja e Nikollë Bregut, sot në SHBA

##### Mësues pensioniste:

-Prenda Gjon Sogja

-Dede Lulash Preka

2- Të nderoi me titullin “Mirënjohja mësuese Kushë Micja”, mësuesit, për kontribute të veçanta në mësimdhënie e drejtues, të disa prej tyre, jo dukagjinas:

a-Motër Michaela Kubickova, nga Çekia, murgeshe e urdhrit Seleziane, 25 vite në Shkodër dhe sot është në detyrën e Drejtoreshës Superiore e Shkollës jo publike “Maria Ndihmëtare”, në Shkodër ...,me motivacion: “Për kontributin shumëvjeçare në qytetin tonë në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore dhe besimin në Zot; për respekt dhe mbështetje të vijueshme



# Figura e Mësuesit është e shenjtë, duhet nderuar dhe respektuar!

XHAHID BUSHATI

TË NDERUAR TË PRANISHËM!

Kjo veprimtari e bukurosh dhe mbresëlënëse i titulluar "Misioni i Mësuesit", për secilin prej nesh, por edhe për mua që mbarta mbi supet shumë vite mësuesie, më sjellin ndërmend dhe kanë zënë vend në kujtesën time shumë kujtime, të cilat edhe sot e kësaj dite, që, edhe pse jam në pension, nuk janë harruar, nuk janë pluhurosuar, mbeten të gjalla, të freskëta por edhe të shtrenjta për mua.

Shpresoj që, nuk duhet të kem qenë më shumë se 28-vjeç, dhe është viti 1981, kur u emërova mësues në Shkollën e mesme të Bashkuar, Breglumi, në zonën e Dukagjinit, zonë që nuk e njihja. Realisht, kisha bërë 5 vite si mësues në një fshat të largët të Kukësit, tani Shkodra nuk m'i ndau malet dhe erdha në këtë zonë të largët, por jo aq të largët sa të Kukësit.

Në këtë shkollë si mësues, jepja mësim në të dy ciklet. Isha dhe mësues kujdestar i një klase, të cilët ato nxënës nuk mund t'i harroj kurrë për respektin që treguan ndaj meje. Edhe sot u them: Faleminderit! Realisht punova vetëm dy vjet, deri në vitin 1983, më pas u transferova.

Gjeta mësues shumë të mirë. Mësora

prej tyre. Më falën mirësi, dashamirësi, dije dhe urtësi. Mbase disa kanë ndërruar dhe jetë, me ndonjërin takohem edhe në Shkodër; takohemi me mall dhe kujtojmë ato vite po me mall, ndonëse edhe kishim vështirësi. Dua të kujtoj mësuesit: Ali Rakiqi, Refik Lekaj, Agim Thorja, Prel Bregu, Ndue Gjonej, Lenë Kodra, Drita Dyrmishi... e të tjerë e të tjerë.

Tani do të ndalem tek nxënësit. Shumë prej tyre i bëra shokë, edhe pse ishim me diferencë moshe, e në pozicione të ndryshme, unë - mësues e ata nxënës. Kam shumë për t'i kujtuar... Duke iu kërkuar ndjesë po përmend disa prej tyre: Vatë Rrasari (që tashmë nuk jeton, nga Molla e Shoshit), Ndue Njemzën, Kolë Tona-jn, Vatë Stakun, Mhill Shkallën, Prendë Koçekun, Nosh Ndreshajn, Dede Prendaj, Kolë Larushkun, Vat Ftonin... e të tjerë e të tjerë. Kuvendimet me to, bisedat për ëndrrat e tyre, të qeshurat e humorin... unë nuk mund t'i harroj kurrë. Ishin nxënës që mësonin, të edukuar, të mirësjellshëm dhe përherë të qeshur me mua. Për ato dy vite që jetova, di dhe nuk gaboj, në dy vite maturantësh pjesa dërmuese shkuan në Shkollën e larta. Shumë prej tyre u bënë me emër të mirë dhe personalitete. Në ecjen e rrugës së tyre, doemos kishim kontribut edhe ne, mësuesit e tyre që i



deshëm si fëmijët tanë.

Në përfundim të kësaj mbrese që jeton deri në frymën e fundit të jetës sime, dua të përmend edhe një moment, mbase është i vogël, po për mua flet shumë. Isha, më vonë, në specializim pasuniversitar, për Kritikë letrare, në Filologjik, në Tiranë. Ngarkesat e mëdha mësimore i realizonim pothuajse çdo ditë në Bibliotekën Kombëtare, ku studionim me orë të tëra. Dhe disa nxënës, me të cilët jeta na bashkoi në Breglumi, ata, tashmë ishin universitarë,

siç duket kishin marrë vesht për ardhjen e passtudimeve të mia në Tiranë, dhe vinin herë pas here të më takonin... Isha shumë i lumtur! Nuk më kishin harruar! Pastaj e pinim kafënë së bashku, krahas kujtimeve të paharrueshme, shtegtonte dhe malli, dhe dimensionin i figurës së nxënësit të dikurshëm, tani universitar, e, sigurisht, me kalimin e viteve, sot janë bërë dhe prindër. Kudo ku kanë ndërtuar jetën dhe punën, ato, kanë si urim nga ana ime: - Paçin bekimet e Zotit! Ju faleminderit!

ndaj prindërve, nxënësve dhe bashkësisë dukagjinase dhe për bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni ju dhe Qendra e Juaj Edukative"

b-Zonjën Alketa Karafili, drejtore e shkollës 9 vjeçare "Martin Camaj", në Shkodër, me motivacion: "Për kontributin shumëvjeçare në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve, nxënësve e bashkësisë dukagjinase dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në shkollën 9 vjeçare "Martin Camaj"

c-Zonjën Briseda Kadia, drejtore e Zyrës Vendore të Arsimit, në Bashkinë Shkodër, me motivacion: "Për kontributin të veçantë në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve e nxënësve dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", në realizimin e misionit të saj; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në punën tuaj drejtuese në institucionin e shkollimit në bashkinë Shkodër"

d-Motër Ardiana Haxhari, drejtore e shkollës 9 vjeçare "Zemra e Krishit", me motivacion: "Për kontributin shumëvjeçare në edukimin e brezave me kulturë bashkëkohore dhe besimin në Zot; për respekt dhe mbështetje të vijueshme ndaj prindërve, nxënësve dhe bashkësisë dukagjinase dhe bashkëpunimin me Shoqatën Atdhetare "Dukagjini"; për shembullin tuaj pozitiv që pasqyroni në shkollën 9 vjeçare "Zemra e Krishit"

e-Kadri Mehmet Ymeraj, ish mësues e drejtor shkolle, në fshatin Bruçaj, me motivacion: "Për kontribut të veçantë në mësimdhënie në zonën e Dukagjinit, në veçanti në fshatin Sumë - Bruçaj, dhe drejtues i suksesshëm i institucioneve të shkollimit në Malësi të Madhe, Shkodër e Lezhë"

3-Të nderojmë me titull të veçante, si më poshtë:

a)Të nderojmë me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", anëtarin e kryesisë se SHAD, zonjën Ledia Dushi, me motivacion: "Poetja, përkthyesja e studiuesja e një përmase evropiane, që do e kishte lakmi pasaportën e Saj çdo vend i vlerave të larta artistike! Fatmirësisht, është zëri ynë, që na bën krenarë. Për kontributin e saj të vijueshëm në realizimin e Misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

b)Të nderojmë me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", anëtarin e SHAD, Rektorin e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Prof. Dr. Tonin Gjuraq, me motivacion: "Krenari për të gjithë ne. Pasqyrë e vërtetë e intelektualit të mirëfilltë. I vetë-investuar në fushën më madhore të shoqërisë, në botën akademike! Shkëlqesë në udhëtimin ditororë, për të gjithë ne. Për kontributin tuaj të vijueshëm në realizimin e Misionit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"

c)Të nderojmë me titullin "Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", anëtarin e SHAD, Administratorin e Universitetit Bujqësor Tiranë, zotin Edmond Tërthorja, me motivacion: "Për aftësitë e tij drejtuese në strukturat larta të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Është modeli i bashkëpunëtorit me pedagoget, studentet dhe

bashkësinë e administratës në këtë institucion të rëndësishëm të shkollimit dhe shkencës të vendit tone, model i punës në realizimin e misionit të shoqatës atdhetare Dukagjini"

d)Të nderojmë me titullin "Anëtar Nderi të shoqatës Atdhetare Dukagjini", kolonelin në pension Et' hem Bardhi, me origjinë nga Peja, që ka punuar në detyra të ndryshme në zonën e Dukagjinit e në zonën e Nënshkodrës, deri komandant Brigade të Këmbëtorisë në Bushat, me motivacion: "Në moshën më të bukur të rinisë tuaj ja dhuruat një pjesë të saj banoreve të Shkodrës, dukagjinase e bregabunas, të cilët ju respektuan, sepse i respektuat, aq sa edhe sot, pas shumë vitesh, që jeni larguar ju kujtojnë me respekt e dashuri. Kuadro si ju i bëjnë vend vetes, por dhe mbeten të gdhendur në mendjet dhe zemrat e tyre. Faleminderit për punën dhe përkushtimin tuaj, faleminderit për lidhjen e qëndrueshme me ne banoret e Shkodrës, të cilët, në veçanti brezi me të cilët punuat, do ta kujtojnë pejanin përherë më shumë respekt"

e) Të nderojmë me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini", sportistin e cilësisë së lartë të volejbollit dhe mësuesin e veçantë në shkollën 9 vjeçare "Dëshmorët e Prishtinës", zotin Nikolin Qafarena, me motivacion: "Mësues i dalluar e sportist i cilësisë së lartë, me kontribute të veçanta për Shkodrën dhe Shqipërinë, duke u kthyer në një shembull frymëzimi dhe krenarie për bashkësinë dukagjinase. Për mbështetjen e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", në realizimin e misionit tonë të përbashkët"

\*\*\*

Një falënderim i vecante për ata, që na mundësuan financiarisht të përgatisim e të zhvillojmë këtë veprimtari: Dede Prendaj, Gjini Markaj e Ndoc Sukaj, me banim në Nju-Jork; Sokol Sterbyqi, Preke Gjonaj, Arben Pepa, Beskin Arinaj, Nikoll Gerla e Ndoc Bregu, me banim në Kanada; Mhill Shkami, Anton Kosteri e Agron Hasanaj, me banim në Shkodër. Paçin e dhënçin!

\*\*\*

Në fund të veprimtarisë, zj. Briseda Kadia, Drejtore e Zyrës Vendore të Arsimit, në Bashkinë Shkodër, theksoj: E nderuar që me ftesë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", të isha pjesë e veprimtarisë të organizuar me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor "Misioni i Mësuesit" Një moment që na kujton edhe një herë rolin e rëndësishëm të mësuesve dhe nxënësve në ruajtjen e vlerave dhe trashëgimisë kulturore. E surprizuar, mirënjohëse dhe e vlerësuar për titullin "Mirënjohje mësuese Kushë Micia". Një nder që më rreshton në morinë e arsimtarëve dhe arsime dashësve, që me punën e tyre kanë kontribuar në përcimin e dijeve, ruajtjen dhe trashëgimin e traditave dhe veçanërisht në ruajtjen e urave të bashkëpunimit në mes bashkësive, në të cilët misioni i mësuesit na ka dhënë fatin të punojmë.

Falenderime të përzemërta për Shoqatën Atdhetare "Dukagjini", për mbështetjen e vijueshme ndaj arsimit dhe për përpjekjet për të ruajtur lidhjet e forta mes bashkësive tona.

Së bashku, mund të ndërtojmë një të ardhme të ndritur, duke ruajtur dhe promovuar vlerat tona të përbashkëta!

# Misioni i Mësuesit

FJALA E N/KRYETARIT TË SHOQATËS ATDHETARE "DUKAGJINI",  
ZOTIT KOLË ÇARDAKU, NË VEPRIMTARINË KUSHTUAR MISIONIT TË MËSUESIT -



Jeta, puna, zhvillimi dhe emancipimi; integrimi e përparimi; lumturia e çdo njeriu si dhe e çdo shoqërie njerëzore varret së pari nga shkollimi dhe edukimi i vijueshëm dhe sa më i mirë gjatë gjithë jetës së njeriut.

Duke i çelur sytë e mendjen, duke ndriçuar rrugët e jetës dhe hapur horizontet, duke ngjallur optimizmin për kapërcimin me sukses të vështirësive dhe duke kthjelluar e hapur vizionin për një të ardhme më të mirë të brezave që vijnë.

Kjo gjë nuk arrihet vetëm nga shkolla e mësuesi në veçanti, por me kontributin e një zinxhiri faktorësh të lidhur e gërshetuar fort së bashku si: objektivë dhe subjektivë, dhe kontributin maksimal të të gjithë këtyre faktorëve së bashku.

Objektivat shtetërorë dhe shoqërorë, kurikulat, programet e tekstet shkollorë e bashkëkohore më të përparuara të kohës.

Kushtet bashkëkohorë sa më cilësore të shkollave, klasave e ambienteve të mësimdhënies, laboratorëve, zhvillimit të praktikave shkollorë e ambienteve të tjera të mësimimit dhe edukimit janë një faktor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për mbarëvajtjen e punës së shkollës dhe arrijtjen e qëllimeve e detyrave të saj.

Faktori kryesor i mësimdhënies e edukimit të vijueshëm të fëmijëve, brezave të një shoqërie të zhvilluar, të emancipuar është misioni njerëzor.

Mësuesit, këshilli pedagogjik dhe institucional i afte profesionalisht dhe i përkushtuar plotësisht në të gjithë procesin e mësimdhënies, përvetësimin të vijueshëm të dijeve, të teksteve shkollorë, teorikisht e praktikisht dhe edukimi gradual sipas moshave e niveleve të nxënësve është misioni i mësuesit.

Në vitin 2022 dhe në këtë vit Shoqata ka zhvilluar takime me nxënësit e nxënëset më të mirë dukagjinase, me mësues e drejtues shkollash në 19 shkolla 9-vjecare dhe 9 shkolla të mesme në fshat e në qytet, duke e sensibilizuar nëpërmjet gazetës "Dukagjini" këta shembuj pozitiv, përfaqësues më të përparuar në çdo shkollë.

Në gjitha këto arritje roli i mësuesit dhe i drejtuesve të shkollave është i pazëvendësueshëm. Për rolin e mësuesit dhe të shkollës Presidenti i SHBA, Abraham Linkoln i drejtonte një letër mësuesit të djalit të tij, kur ai filloi shkollën:

"Mësues, gjithçka për fëmijën tim është e re dhe e çuditshme, prandaj do të doja

ta trajtonit butësisht. \*Kjo është një aventurë e re, që fëmija im do ta marre me vete gjithë jetën. Aventure me ngjarje, luftëra, tragjedi e fatkeqësi.

\*Ta jetosh këtë jete duhet besim, dashuri dhe kuraja. Për këtë i dashur mësues do të lutesha ta merrnit për dore e ti mësonit gjerat, që duhet ti dije fëmija, por butësisht nëse mundeni.

\*Mësojeni fëmijën tim se, për çdo armik ekziston edhe një mik. Ai duhet të mësoje se jo të gjithë njerëzit janë të drejte e jo të gjithë janë të sinqerte.

\*Mësojeni se, për çdo faqezi ka edhe një hero dh për çdo politikan egoist, jeton një lider i përkushtuar. \*Mësojeni nëse mundeni se 10 cent të fituara kane shumë më tepër vlere se 1 dollar i gjetur. Në shkollë mësues, është shumë më e ndershme të dështosh se të mashtrosh.

\*Mësojeni atë si të humb hijeshëm dhe si ti gëzohet fitores kur ai fiton. Mësojeni të jete i mirë, me njerëzit e mirë dhe i ashpër me njerëzit e ashpër.

\*Mësojeni ti qëndroje sa më larg zilise, nëse mundeni mësojani sekretin e një buzëqeshje të çiltër.

\*Mësojeni po të jete e mundur, si të qeshe kur të jete i trishtuar dhe se të derdesh lot nuk është aspak turp.

\*Mësojeni ti përqesh ciniket, por jo ti bulëzojë.

\*Mësojeni nëse mundeni të zbulojë mrekullitë e leximit të librave, duke i dhënë kohen e mjaftueshme, për të kundruar misterin e përjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell dhe të luleve mbi një kodër të gjelbëruar.

\*Mësojeni të ketë besim në idetë e tij dhe nëse të gjithë do të thonë se janë të gabuara. Mundohuni t'i mësoni birit tim forcën për të mos e ndjekur turmën edhe kur të gjithë vrapojnë pas fitimitarit.

\*Mësojeni të dëgjoje me vëmendje çdo njeri, por gjithashtu të shoshit të gjithë atë që e dëgjonte në siten e së vërtetës dhe të marre veç të mirën.

\*Mësojani atij sesi të shesë talentin dhe zgjuarsinë e tij tek ofertuesi më i larte, por të mos pranoje kurrë asnjë lloj çmimi për shpirtin e zemrën.

\*Lejojani të ketë kuraja për të mos qenë i padurueshëm dhe të ketë durim për të qenë trim për të vërteten. Mësojeni atë të ketë besim sublim te vetvetja, sepse atëherë ai do të ketë gjithmonë besim në njerëzimin dhe Zotin.

Këto janë kërkesat, mësues, por ju bëni më të mirën që mundeni. Ai është fëmija i vogël dhe i mirë dhe është im bir".

Me respekt: Abraham Linkoln

\*\*\*

Këto kërkesa janë përmbledhja e asaj që shkolla duhet ti jap brezave të rinj.

Një kërkesë tjetër parësore e domosdoshme për realizimin me sukses të misionit të larte të shkollës është edhe drejtimi bashkëkohor i saj, jo vetëm për peshën si drejtues shkollë, por shumë më tepër nga mënyra e drejtimit të objektivave e

detyrave e punëve drejtuese të shkollës, kurdoherë të kushtëzuara nga shembulli pozitiv i drejtuesit dhe mënyra e metoda efikase, nxitëse e kurajuese për çlirimim e energjive të reja të të gjithë këshillit pedagogjik të shkollës së mësuesve e nxënësve, prindërve e bashkësisë ku shkolla vepron e jeton si dhe të gjitha strukturave drejtuese të shkollës në mënyre çative, të vijueshme dhe të pandërprere gjate gjithë shkollimit të fëmijëve, gjate gjithë procesit mësimorë edukativ e shoqëror të shkollës sonë.

Shkolla është tempulli i dijes ku fëmijët mësojnë dijet dhe arrijtjet botërore të shkencës dhe të teknikes, mësojnë si të sillen te shkollë, në rrugë, familje e shoqëri dhe kudo në bashkësi ku jetojnë.

Edukimi në shkollë i përgatit nxënësit të jenë qytetare të mire, të afte për jetën. Ketë detyre fisnike e humane e kane mësuesit dhe edukatorët si përcues i dijeve, i vlerave e idealeve më fisnike dhe të së rese përparimtare tek brezat e rinjë, tek e ardhmja e çdo kombi.

Kjo është një detyre e vështire, me përgjegjësi të larte profesionale dhe përkushtim maksimal të çdo mësuesi, edukatori e drejtuesi shkollë.

Bashkëpunimi shkollë familje, mësues e nxënës dhe prind është trinomi për arrijtjen e kësaj detyre të larte e fisnike, ku ndërhyrjet politike, paaftësia e korrupsioni nuk zëne vend. Në qoftë se në shëndetësi punonjësi i paaftë vret njerëz, ndërsa në shkollim i paafti, i korruptuari vret breza të terë, vret të ardhmen e një kombi.

Drejtuesit e shkollave e mësuesit si kudo e në çdo profesion duhet të jenë profesionist të përzgjedhur dhe të kualifikuar vijimisht, të përkushtuar për detyrën e lartë, që u është besuar. Ata janë leva e Arkimedidit, që lëviz e çon përpara shoqërinë njerëzore nëpërmjet shkollimit, edukimit të brezave të rinj të një kombi.

Drejtuesi i afte dhe i përgatitur në punën dhe kontrollin e tij të përditshme në shkollë nuk shkon vetëm për të kontrolluar e ndihmuar, por edhe për të mësuar kurdoherë diçka prej tyre.

Shumë here, në punën time në detyrën e mësuesit e drejtues shkollë nga cikli i ulet e deri në shkollën e mesme iu kam përsëritur kolegeve të mi mësues: Ne i mësojmë këta fëmijë çdo ditë, por edhe ne çdo ditë duhet të mësojmë prej tyre.

Të ecësh me mendimin se, unë jam më i miri, unë di gjithçka, duhet të dish se i dituri, më i miri, pa krahasuar nuk gjendet kurrë dhe sa do të dish dijet nuk kanë fund, duhet të mendosh se nuk din asgjë çfarë duhet ditur.

Misioni i shkollës tonë për një të ardhme të mirë dhe të një shoqërie demokratike të afte për tu integruar e përparuar përkrah kombeve të tjerë evropiane kurdoherë e luan shkolla, mësuesit e drejtuesit e përkushtuar të lidhur fort me punën e secilit, në bashkëpunimin e vijueshëm midis shkollës familjes e shoqërisë, pushtetit vendor e qendror, qe-

verise së nxënësve, larg ndërhyrjeve korruptive dhe politike.

Prindi dhe mësuesi duhet të jenë koordinator të shkollës me bashkësinë në mes mësimimit, praktikës dhe jetës.

Është e vërtet se për shkak te zhvillimeve të vrullshme e dinamike të demokratizimit të hierarkisë së marrëdhënieve mësues nxënës dhe prind fëmijë janë krijuar disa pengesa e paqartësi në sistemin edukimit shkollor familjar e shoqëror, por kurdoherë prindi dhe mësuesit me shembullin e tyre pozitiv, me rregullin e disiplinën e forte e kërkesën në punën e tyre do ja dalin që krahas punës mësimorë dhe rritjes së nivelit shkencor, në shkollat tona e familjet tona do te rikthehet fuqishëm edhe puna edukative .Koha kërkon parime te reja modern, demokratike e bashkëkohorë nga prindërit e mësuesit, por edhe nga nxënësit duke respektuar njeri tjetrin me mirëkuptim e rritjen e besimit reciprok dhe personalitetin e individualitetin e njeri - tjetrit. Kjo do të bej, që në shkollë e në familje të krijohet një situatë pune normale e besimi dhe vullneti, për të ecur përpara. Kështu shkolla dhe familja do te kuptojnë më së miri tipologjinë e veçorinë të moshave të fëmijëve, kërkesat e kohës psikologjinë dhe temperamentet e tyre e për tu sjelle disi ndryshe përballe disa sjelljeve të çuditshme të fëmijëve të tyre dhe për të mos krijuar boshllëk edukativ apo për të bere vartës i koncepteve e marrëdhënieve tradicionale të familjes, të cilave ju ka kaluar koha.

Edukimi është një proces i gjate, i vështire që nuk mbaron me ditë as me muaj, por me vite e me kujdes, me durim e angazhim maksimal të të gjithëve dhe sidomos të mësuesve, duke konsideruar shkollën vendin e dijes, të kulturës e edukimit, fëmijës duhet ti japim gjithçka të seleksionuar dhe të kontrolluar, por së pari duhet ti japim dashuri, durim e qetësi, virtyte, që do e shoqërojnë për gjithë jetën.

Pas dashurisë, disiplina e rregulli me jetën e fëmijës është dhurata e dyte me e rëndësishme që i jepet atij.

Shembulli pozitiv i prindërve dhe e mësuesve, rregulli e disiplina në çdo gjë përballe fëmijëve si dhe plotësimi i kushteve për shkollim, veshmbathje e ushqim, shpesh here ka prindër, që e quajnë të përfunduar detyrimet e tij ndaj fëmijës me kaq.

Viti shkollor sapo ka filluar, shkollat janë gati për mësim, shume prej tyre të reja dhe të ri konstruktura, këshilli pedagogjike duhet të jenë plotësisht në plote. Tekstet shkollorë janë ndare pothuajse kudo, një pjese e madhe janë falas, të gjithë mësues e nxënës duhet të përqendrohemi në përvetësimin teorik e praktik të tyre, mbetet vetëm tu urojme gëzuar vitin e Ri shkollor, me suksese dhe na shkoftë mbare në këtë mision të larte fisnike dhe atdhetare!

# Sali Mani - Pasaporta Kulturore e trevës sonë, Malësisë së Madhe, në mbare trojet Shqiptare dhe kudo në Diaspore

Me veprimtarinë e gjithëdijshëm të 20 Shtatorit 2024 të titulluar "Akademi Përkujtimore" si dhe pjesëmarrja e shumë, përshëndetjet e referimet nga më të vlerata të personaliteteve të artit e kulturës, prania e drejtuesve vendorë të Malësisë së Madhe e të Qarkut Shkodër, të medieve lokale, rajonale e kombëtare si dhe financimi e impenjimi maksimal i "Miqve të Sali Manit në Amerikë", me në krye të nderuarit bashkëmalësorë Luigj Gjokaj e Ndue Gjekaj, që e vendosën Këngëtarin e Madh, Sali Mani përjetësisht në Altarin e Kulturës së Kombit Shqiptare, aty ku janë e do mbetën gjithmonë korifenjtë që dhënë në çdo kohë gjithçka për trojet tona e më gjerë.

Ishte e do mbetet një datë historike jo vetëm për trevën tone, Malësi e Madhe, por edhe për mbarë Viset Shqiptare dhe kudo nëpër botë, ku jetojnë e punojnë shqiptarë, ashtu siç do ndihen krenarë të gjithë familjarët e të afërmit tanë (ku edhe unë jam me patjetër pjesë e tyre), por edhe shokët e miqtë, kolegët e dashamirësit e Artistit të Merituar Sali Mani.

Gjithë hapësira e programuar si tek "Akademia" dhe darka e organizuar ishte një atmosferë festive, në të cilën flitej vetëm për 80 vjetorin e lindjes së Sali Manit, sepse të gjithë dëshironin ta kishin në mesin e tyre me poezitë e këngët, me çiftelinë e zërin e tij, me mirësinë e fjalët e arta që ai përcillte tek të gjithë e ku secili donte të fliste "me të" e për të siç kanë biseduar përherë kudo e kurdo ashtu si malësori me malësorin e shqiptari me shqiptarin këtu e në Amerikë.

Emocionet përhapeshin në gjithë hapësirën e "Resort - Deluxe", ku u organizuar zhvillimi i kësaj veprimtarie, për gjithë ditën e të Premtes dhe përhapeshin tek çdo truall yni e kudo në diasporën tone. E kësaj nuk i shpëtoj as drejtuesja e njohur e ekraneve televizive dhe spektakleve të mëdha e nderuara Silvana Braçe, por dhe kritikët e kulturës, profesorët e muzikës, studiuesit e artit si Mjeshtri i Madh Zef Çoba, Besiana Qani Mehmedi, Kadri Fikaj, Lifée Hasa e të tjerë, në të cilën referimet e tyre krijuan një risi më vete në mënyrën studimore e shkencore për çfarë ka kultivuar mendja e dora, stili interpretues e revolucionarizimi i çiftelisë si instrument folklorik i "atij", i cili na mblo dhi aty. Ne veçse ndihemi të çuditur, për kulturën e përgjithshme që e kishte karakterizuar e që na e paraqitën me mjaft profesionalizëm të gjithë të lartpërmendurit, sepse e tillë ishte formimi e inteligenca që gëzonte i madhi Sali Mani.

Për të tilla merita dhjetëra vjeçare të tij në etno-kulturën malësore e shqiptare nuk mund të kalohej pa vlerësime, duke filluar që nga vendlindja e tij Bashkia Malësi e Madhe, e cila me të drejtë nga vitin 2019 Këshilli Bashkiak e ka nderuar Sali Manin me Titullin e Lartë "Qytetarë Nderi" e që iu dorëzua po në këtë veprimtari, nipit të tij nga Kryetari i Bashkisë, Tonin Marinaj

si dhe me titullin "Anëtar Nderi I Shoqatës Atdhetare Dukagjini" nga Kryesia e kësaj Shoqate dhe që u dorëzua nga Kryetari Ndue Sanaj dhe drejtuesja e sektorit të artit e kulturës pranë kësaj shoqate, këngëtarja Viola Shqau (Podja).

Nuk kishin si të mos jepnin opinionet e tyre gjatë "akademisë" në fjalë edhe nga këngëtarja e njohur dardane Shkurte Fe-

Kryetarin e Zv/Kryetarit i Këshillit të Qarkut Shkodër Edmond Ndou e Lulëzim Zaraj, nga Prefektura e Qarkut Shkodër Hysen Hysaj (Nënprefekti Malësi e Madhe), Kryetari i Bashkisë Pukë Rrok Dodaj, kolegët Nikollë Nikprelaj, Jonuz Delaj, Pretash Nilaj, Prek Mrishaj, Fran Kodra, Ndue Shtyani, Gjon Kosteri, Ndue Fusha, Violeta Deda, Fred Delaj, studiuesi Prele

RTSH Radio Televizioni Shqiptar, RTSH Shkodra, TV-Star - plus e televizione nga Dardania, Ilirida, Amerika e të tjera.

E në mbyllje dëshiroj ti them disa fjalë për ato që morën përsipër grumbullimin e fondit dhe bënë të mundur realizimin e gjithë kësaj veprimtarie, që do mbahet mend gjatë për nga mënyra e organizimit e fjala është për Luigj Gjokaj e Ndue Gje-



jza, këngëtarja e talentuar e mjaft i njohur Shkodran Tole, njëkohësisht edhe Drejtor i Ansambllit të Këngëve e Valleve në Maqedoninë e Veriut e të tjerë.

Vetë prania nga gjitha trevat Shqiptare si: Nënkryetari i Parlamentit të Malit të Zi, Nikollë Camaj; Kryetari i Komunës Tuz, Lindon V. Gjellaj; Profetori Sehad Lulanaj; bashkëmalësori ynë në USA, Dede Camaj; shokët e miqtë e ngushtë, Ded Kol Miri Dedvukaj e Anton Ulaj, Administratori i AlbDreams Televizion Rush Dragu, gazetari Zef Përgega, nipat e dy Heronjve të Mëdhenj Isa Boletinit dhe Hasan Prishtinës përkatësht Gazmend Boletini e Mehmet Prishtina, si dhe miqtë nga Dardania, David Ukaj me disa shokë,

Milani e N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Kole Çardaku e të tjerë, duke falënderuar në mënyrë të veçantë Shoqatën Kulturore "Jehona e Kelmendit" me drejtuesen zj. Dila Vacaj, Gjinnazi "Sherif Hoxha", "Dede Gjon Luli", Shkolla që me performancën e bukur të grupeve të valltarëve u bënë jehonë këngëve të mrekullueshme të Sali Manit. E si qershia mbi tortë qëndron filmi dokumentarë "Artistit që i dha shpirtë këngës", me autor malësorin tonë, producentin e gazetarin e mirënjohur Tom Therçaj. Gjithashtu nuk mund të lë pa përmendur edhe pasqyrimin mediatik si: Televizioni Kopliku, Zani Veriut, Malësia Channel, Jeta Shkollore, TV1 Channel - Shkodër, Zëri i Amerikës,

kaj, dy protagonistë, dy miq e shokë, dy përfaqësues të denjë të diasporës, që bënë gjithçka deri në detaj, duke na zbardhur faqen krejt trevës tonë Malësi e Madhe e kudo shqiptarëve nëpër botë. Zoti u dhëntë jetën, shëndetin e mbarësinë personale e familjare! Mirënjohje përherë të gjithë mundësorëve financiarë dhe atyre që u morën me përgatitjen e kësaj veprimtarie, e pagëzuar me emrin "Akademi përkujtimore për Sali Manin" dhe darkën për të ftuarit.

I përjetshëm kujtimi i Sali Manit!

Përgatiti Sytki Ndreca,  
me 21 shtator 2024

# Në ditëlindjen e 70-të të Mark Palnikajt, nderohet nga Papa Françesku!



Mark Palnikaj dhe nderimi nga Papa Françesku

Në një botë ku shpesh historia shkruhet dhe ridizajnohet, Mark Palnikaj është aty si një dritë që shndrin fort duke kërkuar të vërtetat që janë fshehur thellë në arkivat e kohës. Sot, ai feston 70-vjetorin e lindjes.

Një ditë që shënon jo vetëm një përvjetor personal, por edhe një moment feste për të gjithë ata, miqtë e tij të shumtë.

Me një pasion të thellë për kërkimin e së vërtetës, Palnikaj është nderuar edhe nga Papa Françesku, një njohje që thekson rëndësinë e kontributit të tij për njohjen e identitetit tonë kombëtar.

Kryeinxhinieri, që e nisi jetën në shërbim të bashkësisë, ka sfiduar falsifikimet dhe mitet që e rrethojnë historinë tonë.

Ai nuk ka ditur të pushojë, përkundrazi edhe në ato pak orë të lira ka qenë duke hulumtuar për të qenë një hap drejt zbardhjes të së vërtetës.

Guximi dhe vendosmëria kanë ecur paralelisht me të, duke nxjerrë në pah dokumente që nuk ishin bërë asnjëherë të njohura.

E në këtë mënyrë disa perde janë zhbërë nga e shkuara jonë.

Palnikaj ka arritur të hedhë në letër mbi 50 botime, qindra artikuj të shkruar. E pavarësisht se kontributet e tij shpesh kanë mbetur të pavlerësuar nga institucionet shtetërore, ai s'është ndalur duke ndihmuar në ndriçimin e historisë, duke ndihmuar brezat e ardhshëm të kuptojnë rrënjët e tyre.

Në këtë 70-vjetor special, urimet janë të larmishme, por padyshim më i veçanti do të mbetet për të ai i Papa Françeskut. Nderimi nga Papa është si një testament i rëndësishëm për punën e tij të palodhur dhe një thirrje për të gjithë ne që duhet të vlerësojmë dhe mbështesim studiuesit si Marku, që luftojnë gjithmonë për të vërtetën historike.

Nderimi nga Papa Françesku

Palnikaj është i njohur në vendin tonë, veçanërisht nga ata që e duan dhe e dashurojnë të vërtetën.

Sot, të gjithë miqtë po festojnë me inxhinierin, studiuesin Mark Palnikaj.

Një figurë frymëzuese, që me pasionin e tij na ka mësuar se historia është një thesar, që duhet e ruajtur dhe ndarë për brezat. Historia nuk është thjeshtë një grum-

bull fjalësh, por padyshim është një pasuri që ndihmon në formësimin e identitetit tonë kolektiv.

E prandaj për këtë duhet t'i themi "Faleminderit" me të madhe Mark Palnikajt, teksa grupi i redaksisë së Newsbomb.al bashkohet me festën e tij, duke uruar shëndet të plotë e shumë vite të tjera pranë miqve e përherë në shërbim të së vërtetës historiane.

Papa Françesku jep Bekimin dhe mirënjohje për studiuesin Mark Palnikaj në 70 vjetorin e lindjes së tij


Studiuesi i njohur vlerësohet nga Vatikanin në 70 vjetorin e lindjes së tij

Selia e Shenjtë e Vatikanit, me rastin e

Ndërkaq, më poshtë gjeni të plotë nderimin e Papa Françeskut për Mark Palnikajt:

Fjalën e hapjes së kësaj ngjarje e mbajti Prof. dr. Anton Nik Berisha, i cili theksoi: "Të nderuara zonja, të nderuar zotërinj, miq të dashur. Gota që ngriti miku ynë, Mark Palnikaj, nuk është një urim dhe përzemësi i radhës, nuk nënkupton vetëm shënimin e një përvjetori, mbushjen 70 vjet të jetës së tij. Simbolika dhe qënësia e saj dhe e këtij takimi të dëshiruar e të bërë nga ai dhe familja e tij me miq nga Kosova, degëzohet më shumë dhe ka rëndësi me të madhe. Po përmend vetëm dy përbërës të kësaj simbolike. I pari: Punën e tij, sidomos në fushën e kërkimeve shkencore nëpër arkiva të ndryshëm, veçmas të atyre të Vatikanit, përmes të cilëve Marku ndriçoi të kaluarën e njerëzve tanë e të botës sonë. Me përkushtim të madh

dhe nderimin me njëri - tjetrin dhe bashkëpunimin midis nesh pa marrë parasysh fenë, vendin ku jetojmë, moshën dhe punën që bëjme. S'kam ndërmend të bëj vlerësime të punës dhe të hulumtimeve të tij nëpër arkiva për arsye se janë një varg veprash tashmë të botuara që e dëshmojnë këtë më së miri. Tek e fundit, takimi i sotëm nuk duhet të shndërrohet në tryezë fjalimesh nga se nuk e ka atë qëllim. Më lejoni vetëm të përmend këtë fakt: janë edhe 21 mirënjohje, medalje, nderime, që dëshmojnë se institucione e individë në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut dhe në mërgatën tonë e kanë vlerësuar dhe e vlerësojnë punën e tij hulumtuese shkencore dhe botimet që bën. Të sjell këtu vetëm një pjesë të arsytimit pse janë dhënë ato mirënjohje, medalje e falënderime, do të duhej kohe. Po i përmbledh me pak fjalë: përkushti-



70-vjetorit të lindjes së z. Mark Palnikaj ka dërguar nëpërmjet Kadrinalit Apostolik, bekimin dhe mirënjohjen e Shenjtërisë së tij Papa Françesku.

Ceremonia për dorëzimin e këtij Bekimi Apostolik u mbajt në Prishtinë, në një organizim tepër dinjitoz me pjesëmarrës të shumtë si: z. Fatmir Sejdiu ish President i Republikës së Kosovës, z. Agim Çeku ish Kryeministri, Kleriku i shquar Kosovar Don Lush Gjergji, z. Sadri Ramabaja, studiuesit e njohur Prof. dr. Anton Nik Berisha, Prof. dr. Zymer Neziri e shumë personalitete të botes akademike, miq, familjar e dashamires.

dhe me flijim ai bëri të mundur njohjen e disa figurave dhe të rrjedhave të së kaluarës sonë, që nënkupton dhe njohjen e së tashmes sonë. Them kështu nga se e tashmja ka brënda vetes një pjesë të madhe të së kaluarës, ashtu siç e tashmja do të bëhet pjesë e rëndësishme e së nesërme. I dyti: Ky takim i Markut me disa miq të tij nga Kosova, sa di unë i pari i këtij lloji përlligj afrimin e njerëzve që për synime dhe qëllime të ndryshme i ndanë padrejtësisht për rreth një gjysmë qindvjetëshi, para së gjithash, dëshmon ngrohtësinë, mirësinë dhe fisnikërinë e tij, që duhet të mbretërojë edhe tek ne të tjerët: afrimin

mi i madh dhe i vijueshëm në zbulimin e dokumenteve të panjohura deri tani, cilësia e punës dhe flijimi i pakursyer pa u mbështetur nga institucionet dhe nga organet shtetërore përkatëse. Njërin nga këto mirënjohje, që përlligj punën e tij të denjë për nderim në fushën e kërkimeve shkencore dhe ndriçimin e së kaluarës së popullit tonë, është Bekimi Apostolik që ka mbërritur këto ditë nga Selia e Shenjtë, nga papa Françesku. Më lejoni që në emrin tuaj dhe në emrin tim t'i uroj miqut tonë të çmuar, Mark Palnikaj, shëndet, shëndet e shëndet që ta vijojë punën e tij të

# Zbulohet portreti i Gjergj Kastriotit, në Muzeun e Fermos, në Itali



Bashkëbisedoi Eneida Jaçaj

Një portret i panjohur i heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti, është zbuluar në Muzeun e qytetit të Fermos në Itali. Portreti është shumë i vjetër në moshë, i përket një periudhe 471 vjeçare. Sipas një dokumenti, portreti i është dhuruar Muzeut të Fermos, nga një prift në vitin 1550. Portreti i heroit tonë legjendar, prijësit të Arbrit, është zbuluar nga studiuesi i mirënjohur, z. Mark Palnikaj, i cili shkoi për një vizitë studimore në Bibliotekën Komonale "Romolo Spezioli". Ajo që të bën përshtypje në këtë portret ndryshe nga çka e kemi parë, është se hunda me kurriz të dalë nuk paraqitet e tillë; Gjergji paraqitet në një moshë shumë të re, me mollëza të dala, dhe mendohet sipas studiuesve, që i përket periudhës së Rilindjes Europiane, pasi nuk ka autor, dhe kjo është tipike e kësaj periudhe. Zbulimi i këtij portreti tregon qartë marrëdhëniet e ngushta miqësore të prijësit të Arbrit, udhërrëfyesit, strategut legjendar, Gjergj Kastriotit, me Italinë.

Pas krijimit të shtetit të Arbërit, në 1448, Gjergji ishte i pari që vendosi marrëdhëniet diplomatike me shtetet e tjera. Heroi legjendar forcoi marrëdhëniet miqësore me Vatikanin dhe Mbretërinë e Napolit, gjë që e ndihmoi me ushtri dhe financa. Pra, nuk është e rastit, zbulimi i një portreti të tillë. Studiuesi Mark Palnikaj është mjaft i apasionuar me figurën e Gjergj Kastriotit. Siç dihet, ai është autor i librit "Skënderbeu, letërkëmbimet me sulltanët", i mbështetur në dokumente të zbuluara nga vetë ai, nga Arkivi i Bibliotekës Kombëtare të Napolit dhe nga Arkivi Sekret i Vatikanit. Bashkëpunimi i z. Mark Palnikaj me arkivat italiane, është i kahershëm. Palnikaj vijon të studiojë dokumente të vjetra që i përkasin historisë së Shqipërisë dhe pritjet që së shpejti të vijë me zbulime të mëdha.

**-Z. Mark, si u ndeshët me portretin e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut, në Muzeun e qytetit të Fermos, në Itali?**

Me datë 11 deri 14 tetor shkova për një vizitë studimore në Bibliotekën Komonale "Romolo Spezioli", në Arkivin Dioqezan dhe në Muzeun e qytetit të Fermos në Itali. Kjo vizitë më solli një befasi të këndshme, që nuk e kisha imagjinuar. Në murin e sallës së muzeut, krahas dhjetra portreteve të personaliteteve të ndryshme nga Italia dhe nga vende të tjera, ishte i ekspozuar edhe një portret i heroit tonë kombëtar,

Gjergj Kastrioti. Ky portret ndoshta do të më kishte shpëtuar pa e parë, por ishte një rastësi se si ndodhi që unë munda ta shikoja. Midis librave që unë i kam dërguar si dhuratë bibliotekës dhe arkivit, ishin edhe libri im "Skënderbeu, letërkëmbimi me Sulltanët" dhe disa albume mbi Gjergjin. Kur unë i dorëzoja Kryetarit të Provincës së Fermos, Paolo Calcinaro, një album me ngjyra për Gjergjin shkruar në gjuhët shqipe dhe angleze, ai më falenderoi dhe u shpreh se në muzeun e qytetit kemi të ekspozuar një portret të Gjergjit. Unë menjëherë kërkova që të më mundësonin ta shikoja.

**-Cilës periudhë i përket ky portret, dhe si ka ardhur në Muzeun e Fermos?**

Kryetari më shoqëroi në sallën e madhe të mbledhjeve të muzeut ku ishte i ekspozuar portreti. Në murin përballë derës hyrëse, në rreshtin e parë, ky portret ishte i vendosur i dyti midis disa dhjetra portreteve të tjera. Ishte i rrethuar me një kornizë druri shumë të vjetër dhe të shkruar në anën e poshtme me gdhendje shenimi; "SCANDERBERG GIORGIO 1414 + 1467". Reagimi im ishte i menjëhershëm për datën e lindjes dhe të vdekjes së heroit, që sipas meje, ishin të shënuara gabim që të dyja.

Punonjësit e muzeut, krejtësisht të qetë më dhanë sa mundën shpjegimet e tyre mbi këtë reagim timin. Menjëherë më sollën një katalog me ngjyra, ku ishin të botuara fotot e të gjitha pikturave me një shpjegim të shkurtër për secilën prej tyre. Në katalog, poshtë fotos së portretit në fjalë, ishin të shënuara me korrektësi, sipas njohurive që kisha unë, data e lindjes dhe e vdekjes, 1405 dhe 1468. Kur pashë katalogun u binda menjëherë që ndërhyrja ime ishte e panevojshme dhe nuk u zgjata më në këtë diskutim. Ata me shumë mirësjellje më shpjeguan se ky portret ishte dhuruar, sipas dokumentit që ata kishin, nga një prift në vitin 1550, pra 471 vjet, më parë dhe ky ishte një objekt historik mbi të cilin nuk duhej dhe nuk kishte kuptim të vihej dorë.

I falenderova për pritjen dhe për shpjegimet që më dhanë, dhe u largova i kënaqur që shikoja një portret të Heroit tonë Kombëtar, që nuk e kisha parë ndonjëherë. Në vijimësi, mësova se ekziston në një muze tjetër edhe një portret i Gjergjit, me rroba kombëtare të zonës fushore të Shqipërisë së Mesme. Kur i pyeta se në cilin vend ndodhej, rezultoi që ishte 500 kilometra larg dhe unë në këtë vizitë nuk munda të shkoja ta shikoja. Jemi marrë vesh që do të kryej një tjetër udhëtim të planifikuar në Itali, posaçërisht për këtë portret sapo të jetë e mundur. Sipas konsultave me specialistët e pikturës, ky portret ka mjaft veçanti që e bëjnë shumë interesant qoftë në aspektin historik, qoftë në aspektin artistik si një portret i punuar me teknika shumë të veçanta.

**Ja çfarë thotë piktori i njohur nga Mirdita, Pjetër Marku:**

Nuk e kam hasur ndonjë herë këtë portret dhe është i panjohur edhe nga unë në

gjithë njohjet e mija të pikturave kushtuar Heroit tonë. Portreti nuk ka autor dhe si duket autori nuk e ka nënshkruar siç ka ndodhur jo rrallë në periudhën e Rilindjes Europiane. Piktura është një portret i mirëkompozuar, një arritje kjo e periudhës së Rilindjes. Piktoret atë periudhë i kushtonin shumë kujdes vendosjes së pikturës në tela jo si një gjuhë e veçantë komunikimi. Madje ishte kthyer në kanun kërkesa për kompozimin e veprës në tela. Piktoret përlogaritnin saktësisht vendosjen e figurës si edhe hapësirat brenda dhe për rreth saj. Ky portret është vendosur mirë sipas atyre kërkesave dhe eksperiencave të kohës. Së dyti, vizatimi i portretit është i ngjeshur saktësisht i vizatuar me kërkesë profesionale. Autori duhet të ketë pasur eksperiencë pune të gjatë pasi

Përshtypja ime është trajtimi i veshjeve në kontrast me fytyrën. Piktori në mbajtjen e mbulesës së kokës ose kapeles si edhe në veshje, ruan një raport profesional. Mbi kokë ka një kësulë të kuqe shumë të pikturuar impulsive, por që lejon portretin të evidentohet si plan i parë ashtu si edhe veshja e Skënderbeut mes atyre të errtave dhe evidentohen lehtë. Pa hyrë në portretin, kam bindjen se autori ka qënë me eksperiencë të gjatë pune si piktor. Në portret apo fytyrë kemi një gjendje tjetër. Klasikët ndriçonin idenë themelore të veprës, ato kryesisht i shihnin me dritë dhe ngjyrat të thjeshta pa shumë kolorit, por komunikuese me vizitorin. Te portreti sido që ka kujdes të madh në vizatim është mbajtur thuajse monokrom, pa shumë kolor, dhe në një gamë larg gamës



ka ruajtur fort mirë raportet kokë - tors. Ana piktorike. Bie në sy sfondi i pikturës i errët gjë që është bashkëkohor i periudhës klasike italiane, dhe trajtimi koloristik ka profesionalizëm. Në vështrimin tim, ky portret paraqet interes si vepër kushtuar Gjergj Kastriotit, ndërsa përse i përket trajtimit koloristik është në zhvillimet e pikturës së kohës.

**-Çfarë ju bën përshtypje në këtë portret të zbuluar nga z.Palnikaj?**

së veshjeve. Por duhet parë me syrin e piktorit. Ai është një portret me psikologji optimiste, sytë i qeshin figurës. Ai krijon një portret imagjnatë të përafërt me këtë pikturë. Në pamje të parë duket i thjeshtë, komunikues, me kolor të përmbajtur, që vjen nga përvoja krijuese e autorit. Autori e shpreh Skënderbeun shumë njerëzor, si një qytetar më shumë se një luftëtar. Nuk përdor atë përkrenarën dhe veshjen e hekurt që jemi mësuar

ta shohim në portretet e tjera të Skendërbeut. Siç duket, autori kishte në veprat e tij psikologjinë e njerëzve të thjeshtë pa sforcime historike e luftëtari. Unë e shoh në tërësinë e vet këtë portret një vepër tjetër unike kushtuar Gjergj Kastriot-Skenderbeut. Dhe duhet të jetë e fundit të shek XV apo mesit të shek XVI. Gjithnjë duke njohur vepra të asaj periudhe, mosha e kësaj piktore është e madhe. Për mua ardhja e një portreti tjetër nga arkivat Italiane për Skenderbeun tregon miqësinë njerëzore të Skenderbeut me Italinë. Vetë fakti se merret edhe një piktor tjetër ndër shumë piktorë me figurën e tij kjo ka domethënie të madhe. Gjithësesi gjendemi para një veprë arti me vlera historike të herëshme artistike dhe kontribut në historiografinë e artit figurativ kushtuar Skenderbeut.

#### Reagimi i studiuesit Fotaq Andrea

Studiuesi i njohur, Fotaq Andrea, duke analizuar këtë portret është shprehur:

Të falenderoj ngrohtesisht që më dërguat portretin e Gjergj Kastriotit zbuluar këto ditë nga z. Mark Palnikaj në muzeun e Feros si dhe shkrimin shoqëruës për këtë portret.

I shpreh, me këtë rast, përgëzimet e mia z. Palnikaj për botimin e veprës së tij "Skenderbeu dhe letërkëmbimi me Sulltanët", i cili për fat të keq ende nuk më ka rënë në dorë, si dhe për zbulimin e vyer që ai ka bërë në Fermo të portretit aq të veçantë të Heroit tonë, të cilin ma dërguat me dashamirësi. Pa dyshim, ky portret është i Shkolles Italiane të filimit të shekullit XVI dhe menjëherë bie dukshëm në sy pozicioni me profil nga e djathta e personazhit, që është shfaqur për herë të parë në medaljonin e v. 1467-1468 botuar në koleksionin e Pietro Voltalinës dhe studiuar me imtësi nga prof. Lutfi Alia. Po ashtu, bie në sy edhe etiketimi "SCANDERBERG GIORGIO 1414 +



1467", dëshmi e hershme e një emërtese me ndikim franko-flamand kur mbarsa "BERG" shpreh një origjinë fisnikërore të familjeve të mëdha të Perëndimit dhe që e gjejmë për herë të parë tek emertesa "Pirgu i Scanderbergut" në Savojë të Francës me 1448, si dhe më vonë tek botimi i veprës së Barletit në gjermanisht, ilustruar nga Jorg Breyer i Riu me 1533. Për këtë mbarsa "SCANDER - BERG" ka

tërhequr vëmendjen që heret Faik Konica tek Albania e tij e famshme. Sa për datën e lindjes me 1414, dihet se ky variant i pasigurt ka qarkulluar që heret në shekullin XVI e që lidhet me moshën e marrjes peng të djaloshtit Skenderbe (studiuesi Hammer këmbëngul për v. 1414 si vit lindjeje i Skenderbeut), kurse viti 1467 i vdekjes, dihet që jepet sipas kalendarit të vjetër venecian.

#### - Çfare bie në sy konkretisht te ky portret i Gjergj Kastriotit?

Duhet të jetë i periudhës kur është pikturuar edhe portreti i Gjergjit mbi portën e shtëpisë ku ka bujtur në Romë, duke parë midis dy portreteve njëfarë analogjie pozicionale dhe veshjeje, sidomos te tipari i hundës që na jepet disi e drejte, pa kurriz, por me majën disi të rënë, krejt ndryshe nga portreti në ksilografi të Barleti i v. 1510, që e shfaq Gjergjin "legjendar" me hundën e theksuar akilne, një sajesë kjo ala Barletiane.. Është sigurisht me veshje veneciane, por fundi i shamisë shfaqet i plotë nën kapele, më e lartë kjo nga kapa e zakonshme ku KryeHeroi shqiptar na shfaqet në portretet origjinale. Mosha e Heroit jepet më e re, me mollëz të dalë kockore dhe me fytyrë muskulore disi të tërhequr, ku bie në sy hunda edhe buza e poshtme hollake, krejt ndryshe nga "Skenderbeu" i Altissimo-s apo nga "Skenderbeu" i Pinakotekës së Palermos, por që ngjan shumë me portretin e Skenderbeut të shekullit XVI referuar nga F. Kenner, me dallimin se bebja e syrit të "Skenderbeu" i Feros nuk shfaqet e plotë, gjë që le njëfarësoji për të dëshiruar, nëse i besojmë fotografimit që na dhuron publikisht z. Palnikaj. Ndriçimi i faqes, dhe po ashtu i pjesës së ballit dhe të hundës është i ëmbël dhe kontraston dukshëm me krejt pjesën e pasme të errët të imazhit dhe të sfondit, ku është harmonizuar po ashtu edhe e bardha e shamisë nën kapele si dhe mustaku dhe mjekra e shkrifët dhe e derdhur. Një vëzhgim i ngulët tek pjesa e mjekrës dhe e mustakut, si dhe tek pjesa e gëzoftë na shfaq një punë mjeshtërore artistike, ku i është kushtuar kujdes detajit, për ta dhënë sa më të natyrshme, me njëfarë ndikimi nga Van Dyck-u. Këto mund të them në përgjithësi nga një shikim i parë i këtij portreti të ri të Skenderbeut ut realizuar me porosi nga një fisnik i lartë tek një piktor mjeshtër i shkollës ndoshta napolitane, që fakteqësisht mbetet hëpërhe anonim...".

- vijon nga faqja 7 -

qënësisht hulumtuese nëpër arkiva nga se ajo i duhet botës sonë si buka. Shkrimtari i shquar rus Anton Çehov thoshte: "Të moskënaqurit me vetveten është themeli i çdo talenti të vërtetë".

Më lejoni ta ftoj dom Lush Gjergjin, bariun shpirtëror dhe intelektualin tonë, t'ia dorezojë Mark Palnikajt shenjën e bekimit dhe të mirënjohjes nga Papa Françesku."

Ceremonia vijoj me klerikun e njohur Don Lush Gjergji, i cili dorëzoi në emër të Atit të Shenjtë Papa Françesku "Bekimin dhe mirënjohjen e vet Shenjtërisë Papa Françesku".

Presidenti Sejdiu në fjalën e tij të rastit gjithashtu e përgëzoi z. Palnikaj, duke shprehur mirënjohje të thellë për dëshmitë e mira të mbështetjes së Kosovës dhe përkushtimit real të asaj që ka në shpirt dhe në mendje duke e cilësuar si thesar

Kombëtar.

Në fjalën e tij falënderuese z. Palnikaj, shprehu mirënjohjen me konsideratë tepër të lartë në emër të tij dhe familjes, si dhe nënvizoi se do të vijojë të punoj deri në grimcat fundit të jetës dhe të studioj për Kosovën dhe gjithë Shqiptarët.

Ky organizim përveçse një vlerësim i madh për punë e tij në Vatikan, ishte një dëshmi e respektit dhe vlerësimit të madh që bashkësia akademike dhe shoqëria shqiptare kanë për punën dhe përkushtimin e Mark Palnikajt në fushën e historisë.

Kush është Mark Palnikaj?

Mark Palnikaj, studiues dhe albanolog i njohur, konsiderohet përfaqësues i denjë i shkrimeve, dhe studimeve të dokumenteve të vjetra shqipe, përmes të cilave ka gjetur dhe realizuar prurje të reja për gjuhën dhe historinë tone kombëtare.

Është një nga studiuesit e dokumenteve të hershme në arkivat e Vatikanit, Venecias, Napolit e të tjera.

Evidentojmë se z. Palnikaj, ndër vite në sajë të hulumtimeve e studimeve në arkivat prestigjioze e të pa eksploruara më parë të Venecias, Padovas, Napolit dhe Romës ka arritur rezultate të dallueshme shkencore dhe historike.

Këto arritje janë të materializuara e përcjellë institucioneve e publikut nëpërmjet:

· 16 librave të botuar me karakter historik, të bazuar në dokumente Arkivore ekskluzive të panjohura e botuara më parë.

· Botimit të shumë artikujve në gazeta dhe revista me emër në Shqipëri, Itali, Zvicër dhe Sh. B. A. si dhe referateve shkencore dhe pjesëmarrje në simpoziume shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë.

· Ka rreth 200 000 faqeve dokumente në dorëshkrim për Shqipërinë si dhe mbi 4 500 faqe dokumente dorëshkrime arkivore me rëndësi për Historinë e Kosovës

– të siguruara nga hulumtimi prej vitësh në Arkivat e Vatikanit (përfshirë edhe Arkivin Sekret e të tjera), për të cilat vijon puna për transliterimin, përkthimin dhe botimin e tyre.

Vlen tepër të theksohet fakti se, në Arkivat sekrete të Vatikanit, prej disa vitësh i është dedikuar kërkimeve.

Prej 5 vitësh ai kryen studime 1 (një) mujore në arkivin Sekret të Vatikanit si dhe Arkivin e Propagandës Fide, ku me orë të gjata pune ka nxjerrë pafund dokumente të panjohura për Shqipërinë, të cilat plotësojnë thesarin e historisë shqiptare të mesjetës.

Ky burrë, me një karakter tepër të forte dhe me një vetëbesim, të cilin ta imponon puna e tij e pa lodhur për të zbardhur historinë e pa njohur të Shqipërisë ka sjellë një numër dokumentesh 600 vjeçare në dorëshkrim, të cilat i ka botuar dhe vijon ti publikojë.

SHKRUAR NGA REDAKSIA VOX

# Prindërit përballë përgjegjesisë së prindërimit



Fran Gjoka

Në sferën delikate të edukimit qytetar të fëmijëve dhe adoleshentëve ndihet një punë e zbehtë, formale dhe shpesh e papërgjegjshme, ndërkohë që ka shumë shumë kaos e paqartësi lidhur me rolin edukativ të familjes dhe misionin e vështirë të edukimit prindëror. Madje ka tregues që thonë se familja po krijon një vakum edukativ të frikshëm, meqenëse është duke braktisur shumë role sociale, duke e kthyer familjen në një "motel" të thjeshtë ku njerëzit hanë, pinë dhe riprodhohen, por pa pasur përgjegjësinë e duhur për edukimin e fëmijëve dhe adoleshentëve.

## Të edukosh do të thotë kurdoherë të drejtosh

Është e nevojshme në këto rrethana që jemi të bëjmë një rivlerësim të drejtë dhe objektiv. Pavarësisht vështirësive të kohës, pengesave të mëdha të komunikimit edukativ, përsëri asnjë familje nuk zhvillohet, nuk funksionon, nuk konsolidohet pa praninë e një mase të caktuar të autoritetit moral dhe social, natyrisht mbi principe demokratike dhe jo autoritariste të prindërve. Është e vërtetë që për shkak të disa zhvillimeve të vullshme e dinamike, por dhe demokratizimit të hierarkisë së marrëdhënieve prind - fëmijë, janë krijuar shumë pengesa e paqartësi në sistemin e edukimit familjar. Gjithë problemi është që në këto kushte të sigurojmë statusin e familjes dhe funksionimin e saj edukativ.

Kjo nuk është e lehtë në kushtet aktuale kur "distanca" klasike e autoritetit të dikurshëm prindëror në raport me fëmijët dhe adoleshentët është "ngushtuar" shumë. Kjo është arsyeja pse koha kërkon parime të reja moderne të prindërimit me tolerancë, mirëkuptim reciprok. Ata mund të edukohen në familje, në kushtet kur ka atmosferë të besimit reciprok, respektim të personalitetit të fëmijëve, duke ndërtuar një sistem organik edukativ e disiplinor.

Ka shumë prindër, të cilët duke mos kuptuar tipologjinë dhe veçoritë moshore të fëmijëve dhe adoleshentëve, janë të paqartë, psikologjikisht të hutuar, të habitur përballë disa "sjelljeve të çuditshme" të fëmijëve të tyre. Pyetja që duhet bërë

është: kemi fëmijë të vështirë apo prindër që nuk dinë të prindërojnë? Duket se aktualisht ne kemi shumë prindër, që duke mos kuptuar kohën, ndodhen në një "boshllëk edukativ" apo rob të konceptimit tradicionalist të marrëdhënieve me fëmijët, duke u bazuar në parametrat e familjes tradicionale, të cilës i ka kaluar koha. Kjo është një nga arsyet sociale që ka sjellë zhbalancimet të frikshme në sistemin edukativ të familjes dhe marrëdhënieve prind - fëmijë.

Dobësimi i mjeshtërisë së edukimit prindëror është e lidhur me mentalitetin populist sipas të cilit, sido që të vejë puna, fëmijët do rriten në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër. Kjo do të thotë që prindërit lundrojnë në det të hapur pa pasur fare busull. Dy qëndrime të kundërta t'i drejtosh edukativisht fëmijët apo t'i lësh ata të rriten vetvetiu. Të edukosh do të thotë kurdoherë të drejtosh. Në edukimin e fëmijëve recetat e gatshme edukative janë të dëmshme. Zbatimi i rregullave të ngurta të paracaktuara është në kundërshtim të hapur me vetë thelbin e edukimit.

Padyshim, këto gjëra duhen vlerësuar sepse dihet që niveli i një shoqërie të emancipuar dhe qytetëruar nuk mund të arrihet pa një gjithë përfshirje të të gjithë aktorëve dhe faktorëve, që janë të interesuar për mirërritjen dhe mirë edukimin e fëmijëve. Ky formim i vlerave dhe i normave kulturore të kohës nuk mund të sigurohet vetëm me punën dhe kontributin që bën institucioni i edukimit, sado i kualifikuar dhe i vazhdueshëm të jetë. Janë shkolla dhe familja, mjedisi social, komuniteti dhe shoqëria civile, strukturat e nxënëseve dhe prindërve me bordet e tyre në shkolla, që janë ngritur dhe funksionojnë sot në shoqërinë shqiptare, të cilat mund dhe duhet të vihet më mirë në efikasitet që të ndërthurin cilësisht veprimtarinë e tyre të përditshme. Ndaj koha kërkon që prindërit dhe familja, për të luajtur rolin e rëndësishëm edukativ dhe të edukatorit, duhet thelluar procesi i mirëkuptimit dhe demokratizimit të marrëdhënieve prind-fëmijë. Por ky edukim ka nevojë për të përdorur forma, metoda e paradigma edukative moderne të interferimit jo vertikal, por horizontal, si kusht për sukses edukativ me fëmijët. Pa këtë proces edukimi, sado me vullnet të punosh, je i destinuar të dështosh.

## Nxënësit të mësojnë të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve

Aktualisht janë disa struktura: shkolla, familja e mjedisi shoqëror, ku rriten dhe edukohen e ardhmja e vendit, marrin më shumë vlera dhe kanë ndikime më të mëdha në formimin e karakterit dhe të personalitetit të tyre. Është një përfundim jetësor dhe real për një shoqëri që pretendon se është gjithëpërfshirëse në të kundërtën, përjashtimi i kujtudo, është me pasoja katastrofike. Kërkimet e sotme shkencore kanë provuar se përfshirja e prindërve në jetën e brendshme të shkollës

është çelësi për të ndihmuar fëmijët e mësuesit, që ata të jenë të suksesshëm në shkollë e në komunitetin e prindërve. Konstatojmë me kënaqësi përfshirjen e prindërve në të gjithë aspektet e jetës shkollë, kontaktet individuale dhe ato në rrugë informimi të pandërprerë që bën shkolla e mësuesi për fëmijët. Kjo është mjaft e rëndësishme, pasi ata mund të arrijnë të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në shkollë, kështu ata ndihen më mirë me veten e tyre, mësojnë se si të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.

Për të realizuar me sukses këtë imazh të nxënësit, kërkohet kujdesi ritmik për formimin, edukimin dhe kulturimin e tyre, gjë që s'është kurrë e tepërt për prindërit, jo vetëm kaq, por është një nga detyrat organike të familjes së sotme shqiptare, si kolona e parë e përfshirjes së tyre në edukim, ku ka mjaft kapacitete natyrore për të plotësuar këtë objektiv.

Natyrshtëm ndihet sot një merak i pandërprerë i prindërve për të krijuar në familje e shoqëri fëmijë të mbarë, të guximshëm, punëtorë, konkurrues, të edukuar e human. Tendanca e prindërve të sotëm është për t'u krijuar kushte sa më optimale fëmijëve të tyre. Në këto përpjekje të natyrshtë duken edhe dukuri shpërpjesëtimore „preokupime" të tepërta, sforcime të panatyrshme të disa prindërve për t'u krijuar fëmijëve "super kushte" e plotësim kërkesash e pretendimesh të tepruara. E keqja është se disa prindër të integruar "në garën" për të dëshmuar epërsinë materiale të familjes së tyre, nuk janë në gjendje të perceptojnë dëmet morale, psikologjike e sociale që u bëjnë fëmijëve të tyre. Kjo kategori fëmijësh të përkëdhelur, që nuk u mungon asgjë në aspektin ekonomik, të cilët kanë vështirësi në perceptimin e drejtë të raportit të tyre me jetën e përditshme, duke u mësuar fëmijëve shumë më tepër të drejta se sa detyra, detyrimisht kjo ka bërë që fëmijët e të rinjtë të bëhen "të pavarur", nuk e vrasin mendjen për asgjë, pasi gjithçka e gjejnë të gatshme nga prindërit e tyre "zemërmirë".

## Prindërit duhet të jenë këshillues dhe përkrahës në vendimmarrje

Në tërë këto privilegje që u bëhen fëmijëve të intelektualëve të dëgjuar, me emra, paraqiten më të prapë, janë të orientuar drejt akteve të pahijshme me veprimet e tyre keqdashëse se sa shumë fëmijë të tjerë të familjeve të varfër, që me vështirësi sigurojnë çdo ditë bukën e gojës. Me këta të dytët, që s'kanë një qindarkë në xhep, që ushqehen e vishen keq, përsëri shikon një vullnet të paparë në të sjellurit me prindërit dhe mësuesit e tyre.

Prindërit e sotëm duhet të jenë këshillues dhe përkrahës në vendimmarrje, ndryshe humbasin raportin e të drejtave dhe detyrave që kanë ndaj fëmijëve. Në mendimin sociologjik botëror ka sot një shqetësim serioz për këtë dukuri sociale, që lind dhe zhvillohet në gjirin e familjeve

me strukturim të lartë ekonomik. Në realitetin e sotëm shqiptar fatkeqësisht po ballafaqohemi me një brez të ri, që po piqet gjithnjë e më shpejt nga pikëpamja zhvillimore, por jo nga pikëpamjet e tjera më të rëndësishme, padrejtësisht u dalin në krah duke ua falë gabimet, duke i mbrojtur shumë herë pa të drejtë para mësuesve dhe ajo që është më e rëndë, prindërit nuk ushtrojnë kontrollin e tyre se si e shpenzojnë kohën dhe në shoqërinë e kujt ndodhen çdo ditë fëmijët e tyre. Dhe fëmija i prindit indiferent dhe i "punëve të mëdha" e kupton shpejt shfaqjen e dobësive të prindit të tij, ndaj livadhisin poshtë e përpjetë, duke mos ditur nëse ka përgjegjësi prindërore dhe kur rrëshqet në drejtim të gabuar. Sa për informacion: Në Perëndim dhe shumë vende të Bashkimit Evropian është bërë traditë që prindërit të punojnë vullnetarisht në ndihmë të mësuesve të tyre dhe të shkollës në tërësi, ndryshe tek ne ka mjaft prindër që harxhojnë shumë kohë e përpjekje për të siguruar fonde për shkollën. Kjo kohë e harxhuar nuk ka atë vlerë që do të kishte përfshirja e tyre në programet e veçanta të edukimit të fëmijëve. Në gjykimin tim, partneriteti shkollë-familje mbetet tepër e vlefshme, sepse do të njohin më mirë dy palët sistemin e punës mësimore-edukative dhe mjaft probleme të tjera socialpedagogjike që ka shkolla. Ka ardhur koha që çdo shkollë, në qytet apo fshat, të hartojë një politikë të caktuar për përfshirjen e prindërve në edukimin e fëmijëve, ndryshe shqetësimet me të rinjtë do të agravojnë më tej dhe shoqëria shqiptare do të gjendet përballë krimit të rrugës.

## Parandalimi i krimit tek fëmijët problem serioz për shtetin e shoqërinë shqiptare

I bëjmë këtë pyetje vetes: -Pse është rritur kaq shumë numri i të rinjve të dhunshëm? Sepse shoqëria shqiptare mbetet ende e dhunshme, sepse në familje ka dhunë dhe detyrimisht po rrisin fëmijë dhe të rinj të dhunshëm. Të gjitha këto veprime bien ndesh me Kartën e të Drejtave të Fëmijëve, ku mbi ata ushtrohet dhunë psikologjike e fizike si tek prindërit dhe mësuesi dhe ajo që i shpreh rrezikshmëri është dhuna e të rinjve me njëritjetrin. Kujtojmë këtu një shprehje të popullit: "Prindërit është pasqyrë e fëmijës." Ndodh shpesh te prindërit, nëna tregohet "zemërgjerë" dhe plotëson çdo dëshirë të fëmijës, kurse babai jo. Qëndrimet e kundërta të fëmijës i bën ata tekanjozë, duke i futur në debat edhe vetë prindërit. Nëse njëri prind e ndërton dhe tjetri prish, fëmija çekuilibrohet, nuk di kë model prindëror të ndjekë, kur dihet se dy prindërit kanë përgjegjësi të barabartë para ligjit në edukimin dhe shkollimin e tyre.

Detyrë parësore e prindërve është që të dinë në çdo kohë me kë shoqërohet, luan fëmija i tij, kur dihet që edukimi i fëmijëve është një proces i gjatë e i vështirë, që nuk mbaron me ditë e muaj, por me

# Një shkollë e Re modern për mësuesit dhe nxënësit e shkollës “Gjergj Kastrioti”, në Lezhë

Shkolla i mëson njeriut shumë gjëra të vlefshme për jetën, edukimi në shkollë i përgatit nxënësit si të bëhen qytetarë të mirë dhe të aftë për jetën. Shkolla dhe mësimi të edukojnë vlera dhe të zhvillojnë aftësi, njerëzit e arsimuar ndihmojnë në përparimin e shoqërisë, ku rolin kryesor në këtë drejtim e ka mësuesi, përçuesi i idealeve më fisnike, i dijeve dhe i së resë përparimtare në tempullin e madh të dijes, siç është shkolla. Me këtë mision dhe këtë synim, e fillojnë punën këtë vit të ri mësimor, me objektiva dhe synime të qarta, për një ecuri në procesin mësimor-educativ, rezultateve dhe cilësi në shkollim, me arritjen e treguesve mësimor, me punën profesionale, përkushtimin dhe përgjegjësi profesionale, metodike e shkencore, me përçimin e dijeve tek nxënësit, grupit drejtues dhe kolektivi i mësuesve të shkollës pararojë 9-vjeçare “Gjergj Kastrioti”, në qytetin e Lezhës, me drejtoreshën e përkushtuar dhe vizionare, zj. Dije Zefi, një shkollë që mban me nder e

krenari dhe rezultate në shkollim emrin e Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti dhe e vlerësuar për arritje në shkollim nga

Ministria e Arsimit, do ta fillojnë këtë vit mësimor në ambientet komode në shkollën e re moderne, me infrastrukturë, stan-



darde dhe parametra bashkëkohore.

Shkollë, e cila u dëmtua nga tërmeti i vitit 2019, duke u rindërtuar nga e para, me financim të Bashkimit Evropian, një dhuratë e bukur kjo për mësuesit, nxënësit dhe prindërit e tyre në këtë fillim të vitit të ri shkollor, e cila me ambientet e bollshme dhe komode, me hapësirat e nevojshme dhe plot dritë, klasat e të tjera me teknologjinë moderne, në konkretizimin e mësimin, sallën e kompjuterëve, kabinetet-laboratorë, biblioteka, palestra, salla multifunkionale dhe ambientet e tjera kulturore dhe argëtuese për nxënësit, për realizimin e veprimtarive të ndryshme, duke e bërë shkollën sa më efektive, tërheqëse, miqësore, gjithëpërfshirëse dhe komunitare, me praninë edhe të prindërve e bashkësisë, duke gjallëruar jetën kulturore, artistike dhe sportive.

Drejtoresha e palodhur e kësaj shkollë me emër "Gjergj Kastrioti", zj. Dije Zefi, që ka sjellë risi dhe arritje në arsim, mësuesit dhe nxënësit e kësaj shkollë (afër 700 nxënës dhe mbi 50 mësues) falënderojnë për shkollën e re, këtë dhuratë të bukur, duke premtuar se do ta justifikojnë me ecuri, rezultate dhe cilësi në arsim.

**JAK RROZHANI, gazetar, publicist**

## Promovimi i dy librave të ri në poetike nga poeti Mikel Podja

Shoqata e shkrimtarëve në Shkodër promovoi dy libra të autorit të ri Mikel Podja, nga fshati Benë e krahinës së Shllakut me banim në Bardhaj. Prej vitesh është larguar nga vendi për të emigruar në Itali, por tani jeton në Gjermani.

Librin e parë me titull “E dua Ferrin”, Podja ia ka kushtuar krijimeve të artistit të

ndjerë nga Kelmendi, Pjetër Vukaj, duke përmbledhur krijimtarinë e tij në këtë botim.

Libri i dytë me poezi, me titull “Ti shkëlqen”, është i vetë autorit Podja.

Kreu i shoqatës së shkrimtarëve, Prof. Zija Vukaj e ka cilësuar: një autor i së ardhmes dhe e ka vlerësuar lart gjestin fis-

nik të financimit, për krijimet poetike të artistit.

Promovimi i dy librave në një ditë mbledhi poete, shkrimtarë e miq të librit.

Autori Podja thotë, se për të është një detyrim moral përmbledhja e poezive të të ndjerit Pjetër Vukaj në një botim, të cilin e kishte mik të afërt.

Ky shembull i poetit të ri Podja, i cili me shpenzimet e veta botoi librin kushtuar mikut të tij, një artist shumë dimensional, që nuk jeton më, duhet të jetë një frymëzim për të tjerët.

Dy librat “E dua ferrin”, me krijimet e Pjetër Vukes (nda nga jeta) dhe “Ti shkëlqen”, autori Mikel Podja, pasurojnë veprat letrare të shkrimtarëve aktual të Shkodrës.

I urojme suksese në rrugën e bukur të krijimtarisë poetike!

**Përgatiti Zef Nika, Bruksel**



vite, që kërkon kujdes, durim e angazhim maksimal, duke e konsideruar shkollën vendin e dijes dhe të kulturës. Më mbetet në kujtesë biseda e një prindi, ku shprehet: “Fëmijëve duhet t’u japësh gjithçka, veçanërisht dashuri e qetësi, virtyte që do ta shoqërojnë për gjithë jetën. Me fëmijët duhet të komunikosh njësoj si me të rriturit.

Në radhë të parë është dashuria ndaj fëmijës dhe fill pas saj vjen disiplina, që për mua është dhurata e dytë e më e rëndësishme që mund t’i bëhet një fëmije. Mendoj se kjo është mënyra për t’u dhënë atyre një shembull.” Kemi një kategori tjetër

prindërisht, që u lejojnë një sjellje tejet tolerante e më shumë liri se sa duhet dhe as që diskutohet kërkesa e llogarisë ndaj tyre. Kjo kategori fëmijësh bëjnë çfarë të duan dhe nuk kanë kufi si dhe rriten pa pasur aftësitë më të rëndësishme të jetës. Ndaj stili i prindërimit ndikon pozitivisht ose negativisht në moshën e adoleshencës.

Kemi prindër që nuk njohin tipat, të tjerë nuk ia kanë idenë e krizave që përjetojnë fëmijët e tyre në kufi të një moshe. Kemi prindër që s’duan t’ia dinë për interesat që të rinjtë kanë për jetën, shkollën e kulturën në tërësi. Jo pak prindër i konsiderojnë të përfunduara detyrimet

ndaj fëmijëve me plotësimin e kushteve për veshmbathje, ushqim dhe shkollim, kur ata kanë nevojë edhe për argëtim dhe edukim plotësues. Të rinjtë kanë nevojë për një jetë intensive sociale me pjesëmarrje në vendimmarrje, për bashkëpunim e ndërveprim të detyrave të ngarkuara. Bernard Shou këshillonte të rinjtë: “Nëse rruga nga kaloni nuk përbëhet nga kthesa dhe vështirësi, dijeni se ajo nuk ju shpie gjëkund!”

Parandalimi i krimit tek fëmijët mbetet një problem serioz për shtetin e shoqërinë shqiptare, padyshim është dhe pjesë integrale e politikave që MAS duhet marrë

urgjentisht masa të forta ligjore që arsimit dhe edukimi në Shqipëri të bëhet pjesë e pandarë e komunitetit prindëror dhe atij vendor. Sidoqoftë, është koha kur jo vetëm familja, por të gjithë institucionet e sigurisë morale dhe të autoritetit social duhet të bashkojnë forcat, dijet, përvojat edukative, kapacitetet materiale dhe tërë kapitalin human për t’i investuar te fëmijët dhe adoleshentët. Ata janë qytetarët e ardhshëm...

# Dedë Gjon Ujka i Traboinit – Udhëheqës dhe organizator në kryengritjen e Malësisë së Madhe, “Dëshmor i Atdheut”

RRËFIME DHE DËSHMI TË MBLEDHURA NGA GJETO KOLË UCI – CAMAJ

Dedë Gjon Ujka i Vuksanlekajve, Heroi, që u përjetësua në epikat më legjendare të Kombit tonë

Në Malet e Malësisë ishte traditë që burrave më të zëshëm të kohës t'u këndohesh kënga me LAVDË e historia e tyre t'u përcillej brezave si model virtytesh burrie, trimnie, fisnikërie, bese e bujarie. Kështu, kënga ishte dhe mbeti e vetmja dëshmi që shekujt u lejuan malësorëve të memorizojnë në kujtesën e tyre kolektive, historitë dhe ngjarjet e tyre të vërteta, për të mos humbur në pluhurin e harresës. Epika ndër ta mbeti e vetmja dëshmi e gjallë, pasi erërat politike ua ndaluan përdorimin e penës që të shkruajnë në gjuhën e nënës. Dhe jo më kot ka mbetur fjala se: “malësorët patën HUTË e ZEMËR për me luftua, por nuk patën penë me shkrua historinë e tyre” edhe pse gjaku i tyre përgjatë shekujve u derdh lumë me mbrojtje truallin e vendin e t' parëve. Edhe në motet më të vështira të ekzistencës kombëtare, qëndresa e trimave malësor për “jetë a vdekje, ja lirinë”, ishte vendimtare për fatet e Kombit, ku shumë prej tyre e dhanë jetën në beteja frontale me armikun në viset e Malësisë. Fund shekulli XIX dhe fillim shekulli XX në historinë e Shqipërisë shënon një pikë kthese të lavdishme qëndrese, në favor të liritë dhe të ruajtjes së tërësisë territoriale shqiptare, ku sërish rolin kryesor e luajti uniteti malësor, i cili zgjoi një frymë të re atdhetarie dhe mobilizoi rreth vetes bijtë e bijat vullnet mirë, pa ndasi e përkatësi fetare, por me interesa të larta atdhetarie, duke e kthyer Malësinë në një kështjellë të pamposhtur para botës dhe qëllimeve ogurzeza të pushtuesit. Me qindra ishin këngët që e përshkruajnë këtë moment historik, shumë prej të cilave zunë të kthehen në referenca si trashëgimi gojore e pa shkruar. E tillë është edhe kjo rapsodi kushtuar qëndresës së malësorëve në betejën e Qafës së Uglit në 1911 - ten.

Kah po vjen era barotit,  
N'Vuksanlekaj në Mal t'Hotit.  
N'Vuksanlekaj u ba nami,  
Me tabor ka msy Sulltani.  
Ded Gjon Ujka me vllazni,  
Na i del para ksaj ushtri.  
Po kah don ti kah Malsia,  
Se k'to janë trojet e mia.  
Po ta jap besen e Zotit,  
S'ke hi gjallë ti, n'mal të Hotit,  
N'at Qafë t'Uglit kercet pushka,  
Po lufton jaj Ded Gjon Ujka.  
Gjon Tom Hasi trim si zana,  
Paska hy nder nizama,  
Thotë Sulltanin se durojmë,  
Pa gjak Hotin nuk e Ishojm.  
Çka ka toka që gjimon,  
Pjeter Zeku ç'po lufton,  
Si vetima i bjen nizamit,  
Lek Martini shqipe malit,  
Kerset pushka e Lek Martinit,  
Lufton djemet e Traboinit.

Kush ja nxuni turkut priten,  
Jaj Nik Ujka me Luc Niken,  
Shumë nizamat i kanë damtua,  
Municipion shokve tue e çua.  
Kush lufton si era e malit.  
Lek Gjeloshi i Gjelosh Franit.  
Krisi pushka pa ia nda,  
Njaj Luk Nika kenka vra,  
Nik Gjeloshi bani gajret,  
Njaty Nika paska mbet,  
Ded Gjon Ujka trim i rrallë,  
Disa plumba e kanë marrë,  
Gjon Tom Hasi po viket,  
Ded Gjon Ujka paska mbet,  
Vaj me det për kët' far' trimit,  
S'ja la t'shoqin Traboinit.  
Gjon Tom Hasi trim dragua,  
N'at Qaf Ugel ka marua.  
Kajmekani ban medet,  
Shumë ushtria me paska mbet,  
Mallkua kjoft mbreti Stamollit,  
Çi na çoi n'mal të Hotit,  
Kushtrim çon era e barotit,  
Çou të fala Malsia e Hotit.

Falë kësaj game të gjerë këngësh rapsodike, një rol shterues për këtë moment historik ka Kryevepra “Lahuta e Malësisë” me autor At. Gjergj Fishtë, i cili duke iu referuar këtyre këngëve legjendare që këndonin rapsodët rreth oxhakut të kullës, nën dritën e pishës, guxoi të përshkroi në vargje epike të gjitha ngjarjet historike të asaj kohe, të cilat i dëgjoi vetë në konakët dhe katundet e moçme nëpër Malësi, gjatë shërbimit të tij meshtarak të pas vitit 1905, kohë kur zuri të ngjizej edhe “Lahuta e Malësisë”. Në vargjet e At. Gjergj Fishtës përshkruhen ngjarje e bëma trimash që lanë gjurmë të lavdishme në këtë moment historik të identitetit kombëtar. Pikërisht nga këto përshkrime mësohet se Malësia e zhuritur nga betejat frontale nuk u fituan pa gjak. Në lumin e vargjeve të tij tek “Lahuta e Malësisë” përmenden shumë malësor për akte heroike të pa krahasueshme, por ka edhe nga ato ngjarje të asaj kohe, të cilat edhe pse të veshura me shumë lavdi, ceken në mënyrë empirike ose anashkalohen nga përshkrimi historik, duke u lënë në harresë edhe pse këta heronj në memorien kolektive zënë vend nderi në piedestalet më të larta të lirisë. E tillë është edhe jeta e vepra e njërit prej krerëve të Kryengritjes së Malësisë të quajtur Dedë Gjon Ujka i Traboinit - pinjoll i familjes Vuksanlekaj, ku në vargjet e Fishtës përmendet përciptas...

- Dedë Gjon Ujka e Marash Daka,  
- Burra lé për çark t'martinës,  
- Fjalën fjalë, besën çelikut,  
- Ballë për ballë, e jo mbas shpinës,  
- Msue me i rà në luftë armikut...

Në të gjitha ato kontribute njerëzore dhe qëndrese heroike të Dedë Gjon Ujkës së Vuksanlekajve edhe pse qenë ndër më heroiket në Periudhën e Rilindjes Kombëtare, mbeten të memorizuara vetëm në kujtesën e malësorëve, duke mos iu dhënë vlerësimi i merituar nga qarqet akademike të dy shteteve ndërkufitare, ku shtrihet sot Malësia e Madhe, Shqipëri - Mali i Zi, kjo për faktin se në të dy këto “ish shtete” komuniste, familjet feudale u konsideruan si familje armike të popullit, ndaj edhe historia dhe kontributi i tyre jo vetëm që u censurua dhe tjetërsua, por edhe i përndoqën politikisht si elemente të rrezikshëm për pushtetin e secilit shtet, gjatë gjithë periudhës komuniste, aq sa t'i shpronësonin, internonin dhe zhvishnin nga çdo lloj përgjegjësie sociale.

Po kush ishte Dede Gjon Ujka?

- *Mbështetur mbi gojëdhëna të bashkohasve të Ded Gjon Ujkës, të mbledhura nga Gjeto Kolë Uci në një bllok shënimesh vite më parë.*

Sipas të dhënave të shkruara në këtë rrëfenjë të shkruar, thuhet se Dedë Gjon Ujka ka lindur në gjysmën e dytë të shek. XIX, në Vuksanlekaj të Hotit. I rritur nën hijen e kullës hijerëndë prej

guri dhe mësimëve të pleqve të moçëm të stërvitur me përvojën e jetës, u mbush me virtyte burrie e trimnie që në moshë të re. Me të mbushur moshën e djalërisë, falë mprehtësisë së mendjes, shpejt zuri vend në kuvende, duke kapërcyer edhe rrahët e radhës së kuvendit të të moshuarve, tek të cilët i zinte vend edhe fjala, sidomos kur diskutohesh për çështet më të nxehta politike që po i merrnin frymën Malësisë. Dedë Gjon Ujka aso kohe përfaqësonte DEREN e Vuksanlekajve në kuvende, një nga familjet më në za për kohën, e cila veç përbërjes së saj shumë anëtarësh, gëzonte prona e gjë të gjallë sa asnjë tjetër familje në Malësi të Madhe, gjë që e dëshmojnë edhe sot, muret dhe kullat e Sarajeve të Vuksanlekajve në Hot të Malësisë së Madhe. Veç gjendjes ekonomike, kjo familje dallohet edhe për emancipimin kulturorë tejet të rrallë në Malësi të Madhe, çka e dëshmojnë edhe varrezat e Vuksanlekajve, të cilat në vetvete ruajnë ndikimin e hershëm Iliro - Pellazg, ku si askund tjetër, kultura shpirtërore e tyre vjen natyrshëm, e gërshtuar me qëndresën dhe aktualitetin bashkëkohorë të këtyre malësorëve në këtë periudhë. Me këtë frymë dhe vlera humane u rritën bijtë dhe bijat e familjes së Vuksanleka-

## Muzeu historik “Malësia”



Dedë Gjon Ujka

- Patriot i flaktë për çështjen kombëtare.
- Kontribues dhe humanist në sigurimin e bukës dhe barotit për vllazninë e Hotit në ditët e “Zisë së Bukës”, dhe pasojave të betejave të përgjakshme të pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kur Hoti dhe Malësia e Madhe shkruan bohej nga osmanët.
- Një ndër krerët organizues të Kryengritjes së Malësisë së Madhe (1911).
- Prijës dhe komandant i betejës antiosmane në Qafë të Uglit (25 qershor 1911).
- Nderime: “Dëshmor i Atdheut”, Ministria e Mbrojtjes, Republika e Shqipërisë, 2020.

- A fervent patriot for the national cause.
- He was a contributor and humanitarian in providing bread and gunpowder for the brotherhood of Hoti during the “Bread Famine” days and the aftermath of the bloody battles following the Albanian League of Prizren, when Hoti and Malësia e Madhe (the Great Highlands) were ravaged by the Ottomans.
- One of the key organizers of the Malësia e Madhe (the Great Highlands) Uprising (1911).
- Leader and commander of the anti-Ottoman battle at Qafë e Uglit (June 25, 1911).
- Honors: “Martyr of the Homeland”, Ministry of Defense, Republic of Albania, 2020.

jve edhe pse presioni politik i ndoqi e përdoqi për ta ligështua qëndresën e tyre si malësor me virtyte e vlera të larta njerëzore, ku uniteti familjar i mbante të lidhur fort, pas atij krahinor e kombëtar. Ky fat e rroku edhe Dedën, të birin Gjon Ujkës së Vuksanlekajve, të cilit me peshën e moteve mbi supe iu shtua edhe barra e përgjegjësisë për të mbrojtje familjen e për të nderu kullën, fisin e truallin e të parëve, detyrë të cilën e mbajti me nder deri në pikën e fundit të jetës së tij, ku mbeti heroikisht në betejë me turqit në Qafen e Uglit. Dedë Gjon Ujka në memorien e malësorëve bashkëkohës të tij, vjen me tipare të theksuara të një kreshniku malësor. Në këtë përshkrim autori u referohet gojëdhënave të mbledhura nga bashkoheshit e tij, pleq të shtyrë në moshë, por me mëndje të kthjellët, nëpër viset e Malësisë së Madhe, ndër ta:

- Gjon Gjek Lucaj nga Trieshi,
- Kolë Dedë Preli (Nikollaj) nga Trieshi,
- Pjeter Uc Gjoni Camaj nga Vuksanlekaj e Hotit,
- Nikoll Preka Dushaj nga Traboini,
- Haxhi Mustafa (Bajraktar i Hotit),
- Zenel Shabani (Probatin i Dedës në përcjella nga familjarët e tij.)

Referuar gojëdhënave të këtyre pleqve, thuhet se Dedë Gjon Ujka i Vuksanlekajve të Traboinit ishte fort i njohur në Malësi për qëndresë e besë malësori. Rod mirë e njeri i drejtë, por edhe i rreptë me armikun, të cilit i bënte ballë herë i vetëm e herë me vllazni, duke iu dalë në pritë shpesh herë ushtarëve turq, të cilët vinin të mblidhnin haraçin (detyrimet) në Malësi, apo të kryenin shërbime e arrestime me ferman zyrtar. ... "Me tramë e merrnin rrugën ushtarët, prej frikës se Deda mund t'u kishte zanë pritë tek Shkami i Kuq mbi Podgoricë (në veri të Podgoricës)". Për këto dëme të herë pas hershme, Veziri i Shkodrës i thërret krerët e Malësisë në një takim të detyruar dhe i pyet; po kush po m'i vret ushtarët tek Shkami i Kuq? Në këtë moment Deli Meta Ba-

jraktari i Hotit, tujë e njoftë mirë zemër luanin i kthehet; fol djali i Vuksanleke! Atëherë Deda me atë maturinë që e karakterizonte, i kthehet butësisht Vezirit; Zotni, kur e punon shpinë a e punon me të ra pikat e shiut në huajën a në tatën? Në këtë moment Veziri mundohet me kuptua mendimin e hollë të këtij malësori dhe për mos me acarua zemërimin e krerëve të Malësisë, detyrohet të bëjë paqe me ta. Sipas pleqve thuhej se Dedë Gjon Ujka kishte vulën e vet (mhyr i personalizuar,) e cila njihej nga të gjitha Bashkimet e Krerëve të Maleve të Malësisë e ma gjanë. Për të ruajtur saktësinë e dëshmisë së pleqve që përmban dorëshkrimi, thuhet se: diku pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (mbas Marsit të vitit 1878,) Dedë Gjon Ujka me disa shokë sulmuan një kazermë (çertifikatë) turke, ku i vrasin disa ushtar. Mbas disa ditësh ushtria otomane sulmuan Hotin, ku e bëjnë shkrumb e hi, duke vra e plaçkitë popullsinë e pafajshme. Thuhet se Dedë Gjon Ujka ishte i fuqishëm ekonomikisht dhe ushtarakisht, çka e bënte të besueshëm edhe në rrethin e tregtarëve më të mëdhenj. Për t'i majtë frymën gjallë Hotit, Dedë Gjon Ujka merr gjithë bereqetin e hambarëve të Toptanëve dhe ia ndau Hotit. Lufta, hallet, jeta e keqe, bani që malësorët e Hotit të bien në pikë të hallit që nuk po munden me i kthye borxhin të zotit. I gjendur në vështirësi me mikun që i kishte ra në qafë, e nga ana tjetër me vllazninë e Hotit, që nuk kishin asnjë mundësi me e kthye detyrimin, Dede Gjon Ujka detyrohet të shesë pronat e veta për t'i paguar borxhin Toptanëve. Ai shiti tokën në Kamicë, dy dugaja në Shkodër, një palë mullinj, një bjeshkë dhe dy dygaja në Podgoricë. Në dëshminë e pleqve, Dedë Gjon Ujka ishte shumë aktiv në kuvende. Ai mori pjesë me krerët e Malësisë në Kuvendin e Greçes, siç e quajnë malësorët "12 kalemata" e "Librit të kuq", apo 12 kërkesat e otomaneve. Dedë Gjon Ujka është një nga personat ma gjallnik që u angazhua për përgatitjen e një Kryengritje me Krye-

krerët e gjuhës, Kombit dhe Atdheut. Me klerikët katolik, me Mehmet Shpendin, Ujkë Dushin, Gjeto Markun, Smajl Martinin e shumë patriotë të tjerë. Në këtë lëvizje u përfshinë edhe me kushërinjtë e tij Nikë Prelocin, Mirash Hasin e Smajl Markun, duke iu kushtuar totalisht kryengritjes të gjithë. Pleqtë tregojnë se kur autoritetet turke hetuan se çka po ndodhte në Malësi, filluan t'i mësyjnë me ushtri. Shumë nga kryengritësit u zunë rob. Disa i masakruan, disa i burgosën e disa të tjerë i internuan në Anadoll. Ndër ta ishte edhe Smajl Martini, Bajraktari i Grudës, të cilit simbas pleqve, as sot e kësaj dite nuk i dihet ku i ka eshtrnit. Në krye të javës Ujkë Dushi e Mirash Hasi u orientuan mbas kishave. Simbas pleqve ky ishte edhe organizimi i parë i malësorëve për Kryengritjen e Madhe kundër otomanëve.

#### Beteja e madhe dhe e përgjakshme e kryengritjes në qafë të Uglit

Simbas asaj që u tha ma vonë Pasha përgatiti mijëra forca ushtarake për me nënshtruar malësorët të cilët i lëshoi si një "shëmble" në drejtim të Maleve të Malësisë. Birimxhi taborët i nisi për në Hot.

Ndërkohë Dedë Gjon Ujka organizon vllazninë e Vuksanlekajve, kushtrimit të të cilit i bashkohen për jetë a vdekje 32 burra të rinj e të vjetër. Në këtë betejë Dedës i bashkëngjitet edhe shoku e vëllai i tij i pandarë, Gjeto Marku i Rapshës. Po simbas pleqve në këtë betejë morën pjesë kryengritës nga të gjitha malet e Malësisë. Nga Hoti, nga Gruda, Trieshi, Koja, Kastrati, Shkreli e të tjerë. Kryekomandant i kryengritësve malësorë në këtë betejë të përgjakshme kundër taborëve turke, ishte Dedë Gjon Ujka. Në këtë kushtrim, për t'u ardhë ndihmë vllazenve malësorë, u bashkuan edhe gratë e vajzat e Vuksanlekajve të Hotit. Ato bënë barot, të plagosur e në shumë raste luftonin bash si burrat, kur në llogore kishte mbete i vranë luftëtar.

Lufta ishte shumë e përgjakshme

e pasojat fatale. U dogjën kulla e frëngji që u kishin rezistua shekujve. Lufta u fitua por me dame shumë të mëdha. Në këtë betejë të përgjakshme petën (mbetën) rreth 20 hotjanë të vdekur e shumë malsuer të tjerë. Birinxhi taborët u shkartuan. Për gjallë vetëm komandanti me dy a tre ushtar. Ai kishte thanë se: kam luftuar boll e kam fituar shumë beteja, por për të paren herë kam pa ka komandojnë në luftë LUAJ E LUANESHA, kjo në prezencë të Zenel Shabanit të Kastratit, i cili për tu dhanë zemër fatosave të lirisë e mos me i humb kurrë nderi, derës së Vuksanlekajve, e ka kuvendë me qindra herë pas asaj lufte sa kje gjallë. Kjo kryengritje u vulos me gjakun e Kryekomandantit të saj, Dedë Gjon Ujkës së Vuksanlekajve, i cili ishte edhe një nga udhëheqësit më të ndritur të Kryengritjes së Malësisë së Madhe. Në këtë betejë Deda mbeti i vranë bashkë me katër djelmni të derës së Vuksanlekajve.

Të vranë:

- Dedë Gjon Ujka Kryekomandant
- Gjon Toma Hasi
- Gjek Martini
- Nikë Gjeloşi
- Lukë Nika

Të plagosur:

- Lucë Nika
- Nikë Ujka
- Pjeter Zeku
- Lekë Martini
- Lekë Gjeloşi

Të gjithë kushërinjtë të afërm të derës së Vuksanlekajve.

#### DEDË GJON UJKA DËSHMOR I ATDHEUT

Për figura më të shquara dhe më të lavdishme të popullit tonë mirënjohja kolektive nuk është kurrë e mjaftueshme, prandaj memorialët dhe shtatorët që zënë sheshet, shkrimet dhe simpoziumet shkencore, librat apo dokumentaret kushtuar atyre, marrin kuptim sa herë që lakohen e sillen në vëmendje. Kujtohen e nderohen për heroizmin, për sakrificën, për qëndresën dhe besën e dhënë ndaj Atdheut për të cilin nuk kursyen as jetën e tyre. Betimi i tyre për "jetë a vdekje, ja lirinë" dhe rënia e tyre në fushëbetejë, bënë që këta heronj, Fatosë të Lirisë të shquhen përjetësisht si "DËSHMOR TË ARDHEUT". me apo pa vendim zyrtar. Një vend nderi në altarin e lirisë, të zyrtarizuar edhe nga institucionet zë edhe Dëshmorit Dedë Gjon Ujka i Traboinit, pinjoll i familjes Vuksanlekaj.

Shpallja e Dedë Gjon Ujkës "Dëshmorit i Atdheut" nga Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë me 15. 08. 2020, është një nga vendimet më sublimë, që një institucion shtetëror ndërmerr për të lartësuar këtë figurë të shquar të popullit tone, i cili ra heroikisht në betejën më të përgjakshme frontale gjatë kryengritjes së Malësisë në pranverën vitit 1911 në Qafen e Uglit.

I përjetshëm qoftë kujtimi i tij, në jetë të jetëve!

Nga Rita Shkurtaj  
Gusht 2024



# Dedë Prendaj - Shaljani amerikan i suksesshëm

Nenmavriqi i Shalës ndër shekuj ka zënë vend të rëndësishëm në të gjitha ngjarjet kulmore që Shala e Dukagjini kanë zhvilluar, duke pasur një histori të lavdishme e nxjerrë burra me emër, të urtë e trima, duke përkrahur gjithnjë progresin. Bijtë e bijat e këtij fshati gjithmonë kanë qenë të etur për dije. Kur u krijuan mundësitë për t'u shkolluar, nga ky fshat mbaruan shkollat e larta në degë të ndryshme, për: mësuesi, mjekësi, ekonomi, art e kulture dhe ushtarakë, më shumë se çdo fshat tjetër, madje më shumë se shumë fshatra të marruara së bashku, duke shërbyer anë e kënd vendit. Një ndër ta shumë i etur për dije dhe i suksesshëm është edhe Dedë Mhill Prendaj, sot shtetas amerikan.

Kush është Dedë Prendaj?

Deda u lind me 21 janar 1964, në fshatin Nënnavriq, lagjia Quk, pjesë e fisit Pecaj, nga një familje me emër të mirë në të gjithë Shalën, me tradita patriotike, atdhetare dhe shumë bujare, me prindër Mhill Çuni e Mri Prekja, bijë nga një familje emërmadhe nga Dragajt (Lekaj) e Shalës. Mësimet e para të shkollimit i mori në fshatin e lindjes kurse shkollimin 8 vjeçar e të mesëm në shkollën e mesme të bashkuar "Mehmet Shpendi", në Breglumi, të cilat i përfundoi në vitin 1983, me rezultate të shkëlqyera, duke bërë diferencën ndër bashkëmohatarët e tij, i cili shquhej sidomos në shkencat ekzaktë. I prirur për të ditur sa më shumë, kishte shumë dëshirë të vijonte shkollën e lartë në degët ku shkëlqente më shumë, me shpresë se aty do jepte më tepër. Por pushteti vendor i kohës i nxori shumë pengesa në kuadër të luftës famëkeqe të klasave, duke i cilësuar më shumë biografine nga dajat e babës, i cili ishte nip tek Deli Marashi i Shoshit, familje me shumë emër e histori, sesa dajat e Dedës, të cilët ishin shumë të suksesshëm për kohën, vëllai i nënës, Prof. doktori i nderuar Vuksan Kola, një ndër mjekët më të suksesshëm të mjekësisë shqiptare. Të drejtën e studimit jua dhanë disave me rezultate më të dobëta, por ishin gjoja më afër partisë, por falë këmbënguljes së paepur të Dedës dhe mirësisë të kryetarit të komitetit ekzekutiv të Shkodrës, e fitoj të drejtën e studimit në shkollën e lartë, sigurisht jo në degët që donte, por në Institutin e lartë bujqësor Kamëz - Tiranë, dega agronomi, të cilin e përfundoi në vitin 1988 me rezultate të larta.

Në janar të vitit 1988 fillon punë në detyrën e kryeagronomit në ekonominë bujqësore Shalë, duke iu dhënë mundësia që njohuritë shkencore të fituara në auditorë t'i vënë në jetë, në praktikë. Luftoj me mish e shpirte që të merren rendimente të larta, duke shkuar parcelë në parcelë, duke dhënë këshilla me mënyrën e tij të komunikimit, por nuk ja arriti, me gjithë dëshirën, sepse sistemi kooperativist ishte në gërhimat e fundit, i cili pas dy vitesh

dha "shpirt".

Deda, ndër të parët shaljan përkrahur ndryshimin e sistemit, duke e quajtur një domosdoshmëri pluralizmin politik dhe ju përkushtua forcimit e konsolidimit të



pushtetit të ri vendor. Ishte ndër të rrallët që vlerësonte me objektivitet të dy sistemet me të mirat dhe të këqijat e tyre. Sigurisht që nuk ishte dakord me disa plagë që sistemi i ri krijoj. Duke parë te Deda aftësitë organizative e menaxhuese, në vitet 1991-1992 ushtroj detyrën e Kryetarit të këshillit të bashkuar Gimaj - Nënnavriq-Lotaj. Me ndarjen e re administrative, ku Shala u bë komunë, në zgjedhjet e para pluralistë të vitit 1992 u zgjodh kryetar komune, për vitet 1992-96 dhe duke u nisur nga puna e mirë e bërë u rizgjedh në këtë detyrë edhe në vitin 1996 që e vazhdoi deri në vitin 1998, vit në të cilin largohet nga Shqipëria. Për dhjetë vjet që shërbeu në vendlindje me detyra ta ndryshme sidomos në pushtetin vendor, ishte shumë i përkushtuar dhe i ndërgjegjshëm, duke vënë mbi gjithçka interesin e punës. Dha një kontribut të vyer për konsolidimin e pushtetit vendor, si hallkë e re e sistemit demokratik. Në kuptimin e mirë të fjalës ishte kryetar i çdo shaljani pa dallime partiake siç ka ndodhur me ca të tjerë. Kishte një mënyrë të veçantë komunikimi me njerëzit e të gjitha moshave e niveleve kulturore. Ishte i prirur për të bërë vetëm mire, duke zgjidhur me mundësitë që kishte hallet e popullit, sidomos të atyre me nevoja ekonomike. Tek Deda ishin të harmonizuara vetitë e virtytet më të mira

të trashëguara, me edukatën e fituar në shkollat e sidomos në shkollën e jetës. Ishte fjalëpake e punë shume. Sa i dashur e i respektuar me të gjithë, aq ishte edhe i papajtuashëm me të metat e mangësitë që vrenjte dhe përpiquej për eliminimin e tyre. Nuk ishte i prirur për privilegje e favore që detyrat ja krijonin ato mundësi siç bënë pasardhësit e tij, por gjatë gjithë kohës jetoj në shtëpinë e prindërve, afër tyre e bashkësisë që drejtonte. Edhe Deda kishte dëshirë të përfshihej në lëvizjen demografike për një jetë më të mirë si shumë të tjerë. Ishte për një lëvizje të kontrolluar ku edhe kontribuoj shumë. Si gjithmonë, edhe kësaj here i buzëqeshi fati, i doli lotaria amerikane dhe në korrik të vitit 1998 u largua nga atdheu me shumë malli e nostalgji dhe u vendos në NEW-JORK të Amerikës, ku jeton edhe sot. Si çdo emigrant, edhe Deda i pati vështirësitë e veta të fillimit, në një vend të huaj, probleme pune e gjuhë, por falë vitalitetit dhe vendosmërisë së tij si dhe optimizmit që gjithmonë e ka karakterizuar, këto vështirësi të fillimit i kaloi shumë shpejt dhe u integrua shpejt në jetën amerikane e sot bën një jetë normale si një amerikan autokton. Menjëherë u stabilizua në punë se Amerika ta jep këtë favor, fillimisht në një kompani elektrike. Eci me një kohë rekord me gjuhën, duke përvetësua me të folur dhe të shkruar anglishten. Ai nuk u mjaftua me njohuritë që kishte apo përpjekjet individuale, por vazhdoi shkollat e rregullta siç ishte "Instituti për biznes e teknologji" në vitet 1998-2002 dhe arriti të fitojë pavarësinë e plotë duke u bërë vetë menaxher, duke punësuar shumë njerëz, sidomos njerëzit e vet, të cilët i tërhoqi nga Shqipëria, siç ishin vëllezërit Pali e Bardhoku, me familjet e tyre dhe sot punojnë e jetojnë pranë njëri tjetrit. Sot Deda është tamam një enciklopedist, e njeh New-Jorkun më mirë se një amerikan në moshë madhore, lind e rrit aty, e bën cicëronin më mirë se askush tjetër. Këtë e kam me të provuar e jo me të dëgjuar.

Deda është edhe një familjar i shkëlqyer. Në vitin 1995 u martua me Luçe Gjoni, vajzën e zamadhit Kolë Gjoni nga Kiri, të cilët lindën e rritën tre fëmijë të mrekullueshëm (dy në Shqipëri), Romarion, Brikenën dhe Jissica, sot të shkolluar në shkollat më prestigjioze, me rezultate shumë të larta, sidomos në fushën e teknologjisë bashkëkohore, të cilët kanë krijuar pavarësinë e tyre, me një formim e kulturë për t'u pasur zili, duke qenë shembull për bashkëmohatarët e tyre edhe në artikullimin e gjuhës shqipe. Këtu është roli i padiskutueshëm i prindërve, me të cilët mentalisht jetojnë.

Me gjithë jetën shumë të mirë në Amerikë, Dedën malli për vendlindjen e atdheun nuk e len për asnjë çast. Si shumë human dhe i përkushtuar që është, ka kon-

tribuar financiarisht shumë për Shalën bashkë me shaljan të tjerë, duke filluar që nga ndihmat për familjet në nevojë gjatë kohës së pandemisë; përmirësimin e infrastrukturës së Shalës si në ura, rrugë, shkolla, kisha e deri në Truporen e Shna Ndout, apo memorialin e T' lumnuemve dukagjinas. Në veprimtarinë për këtë të fundit ishte organizator dhe mbajti fjalën përshëndetëse shumë mbresëlënëse, në të cilën shfaqti një oratori të admirueshme, që vetëm një njeri me horizont të gjerë kulturor, historik e artistik mund ta bëjë.

Ja si shprehet Ai "Këta martir që mbajtën në gjenet e tyre brumin e truallit të tyre arbëror dukagjinas, të gatuar në magjen e kryeqendrës së kulturës e historisë kombëtare, Shkodrën tonë, e mëlmym me yndyrën akademike të universiteteve më në zë të Evropës, ishin dhe mbeten fondi ynë i artë i dijes dhe idealeve njerëzore". Në zyrën e tij lindi nisma: "Shaljanët në SHBA për trojet e tyre". Nismë, e cila tanimë i ka dhënë frutat e veta. Aftësitë e tij i shprehu edhe në përshëndetjen në veprimtarinë "Shaljanët në emigrim për trojet e tyre", të cilën e titulloj "Dukagjini korrelatë e shkurtër historike", i cili bën një përshkrim historik të Dukagjinit, duke paraqit me realizëm momentet më kulmore të tij në shekuj dhe jep mesazhin: "Jemi kryelartë për të kaluarën, por duke mos harruar se kemi shumë detyrime ndaj vendit ku lindëm e u rritëm, sepse duke mos harruar të kaluarën vlerësojmë më mirë të ardhmen dhe mund t' u lëmë një trashëgimi të bukur vlerash njerëzore e shpirtërore gjeneratave të reja".

Deda ka një cilësi të veçantë nga bashkëkombësit e vet, punën e bën, kontribuon më shumë se shumë të tjerë, por nuk donë me u duktë, nuk është i prirur ndaj mediave, duke u nis nga motoja: Të flasin të tjerët për mua e jo unë për vete. Sigurisht që në të gjitha veprimtaritë që janë zhvilluar në Shalë, bashkëpunëtor kryesor Deda ka pasur z. Gjin Markaj, për të cilin ka shkruar edhe gazeta "Dukagjini". Deda ka qenë dhe është bashkëpunëtor i shoqatës atdhetare "Dukagjini" e me gazetën e saj, duke e ushqyer me shkrimet e tij cilësore, por ka kontribuar edhe financiarisht, duke mundësuar financiarisht ndonjë numër të gazetës "Dukagjini", si dhe disa veprimtari, që shoqata ka zhvilluar kohet e fundit, për të cilat ka marrë falënderimet më të mira. Ka mundësuar financiarisht edhe për botimin e librave me autor dukagjinas, siç kanë qenë librat për Ndok Gjelošin e Dodë Tahirin, me autor Prelë Milanin, si dhe ka qenë bashkefinancues në të gjitha koncertet e zhvilluara në çdo fund viti në New - Jork të organizuara nga Kujtim Funiçi.

Paraqita copëza nga jeta dhe veprimtaria e fisnikut, familjarit e qytetarit model, të shaljani - amerikanit të suksesshëm, Dedë Prendaj, i cili emrin e mirë që ka e formoj në vendlindje dhe e konsolidoj ende më shumë në Amerikën e largët, duke bërë një jetë shumë aktive e gjurmëlënëse midis dy kontinenteve, të cilin malli për vendlindjen nuk e len për asnjë çast.

I urojmë jetë të gjatë e të shëndetshme, të lumtur bashkë me familjen e tij shembullore, vital, aktiv e i suksesshëm si deri tani në të mirë të familjes, shoqërisë, bashkësisë dukagjinas e më gjerë!

**Prelë Shytani,**  
Shkodër, shtator 2024

# Prenda Sejdia - studiuese, mësuese, veprimtare kombëtare, poete dhe kritike e shquar letrare

## Zekerija Idrizi

Ka vite që e ndjekë me vëmendje veprimtarinë e gjithmbarshme politike, pedagogjike-arsimore, studimore dhe letrare të zonjës së fisme e inteligjente Prenda Sejdia. Dorën në zemër, më ka mrekulluar i tërë opusi i saj i begatë studimor e letrar. Veçanërisht më ka çuditur tejmase muza e saj kreatoriale në fushën e poezisë dhe të vështrimeve të saj kritiko-letrare për shumë vepra poetike e romanore të autorëve të ndryshëm shqiptarë.

Zonjë Prenda është një Grua shumë me dinjitet, që një jetë të tërë ia ka kushtuar arsimit e politikës kombëtare, si dhe letërsisë sonë shqipe. Ajo vijon edhe sot e kësaj dite të veprojë me zell dhe përkushtim të thellë në sektorët e theksuar. Po kaq aktive dhe produktive ajo është edhe në punën e angazhimet e saj maksimale në fushën e të drejtave të grave, të barazisë gjinore, të luftimit të dhunës në familje dhe në integrimin e plotë të grave në gjitha sektorët e shoqërisë e të shtetit shqiptar.

Ajo jo vetëm në Shqipëri, por edhe në gjitha trojet etnike shqiptare është mjaft aktive në organizimin dhe pjesëmarrjen aktive në shumë ngjarje, manifestime e konkurse letrare.

Veprimtaria e saj shumëdimensionale i ka bërë dhe i bën akoma një nder të veçantë dhe një ndihmesë të madhe kauzës sonë kombëtare dhe, në mënyrë të veçantë, edhe letërsisë sonë shqiptare...

\*\*\*

Zonjë Prenda Sejdia është e lindur në fshatin e bukur Bugjon (PUKË). Rrënjët e saj janë të thella sa vetë jeta, ku atje flet fisnikëria e gjuhës e zonës së krahinës madhështorë të Thaçit.

Në moshën e saj të njomë, familja e saj u vendos në Tropojën kreshnike, ku veçon mirësinë që ka bashkësia e kësaj ane, si malësorë të Malësisë së Gjakovës. Ajo u pajis me plot virtyte humane e njerëzore, që e kanë përcjellë dhe do ta përcjellin gjatë gjithë rritjes e jetës së saj.

Këtu mbaroi mësimet fillore e të mesme. U diplomua në Universitetin "Luigj Gurakuqi" të Shkodrës. Kreu Fakultetin e Mësuesisë.

Që nga viti 1993 punon e vepron në Lezhën e Besëlidhjes, këtë qytet model me tradita kulturore, patriotike e atdhetare.

Marrëdhëniet e shkëlqyera me familjarë, miq e të afërm kanë qenë çelësi i suksesit dhe gjithë botëkuptimi i saj, që e përcjell si personalitet.

Puka -Tropoja - Lezha është ky trekëndëshi, që i jep botëkuptim punës, jetës e veprimtarive, por dhe krijimtarisë së saj studimore e letrare.

## Puna e saj profesionale

- Profesionit Mësuese ku ka qenë mësime të punës për 16 vite me radhë.

- Një mandat ka qenë zv. Kryetare e Komunitetit Ballë Lezhë.

- Tre vite ka qenë Drejtore e burimeve Njerëzore në Rezidenca Studentore 2, Tiranë.

- Aktualisht punon në Arkiv.

- Si pjesë e politikës vendore ka qenë e organizuar për 28 vite, ku veçohet si drejtuese e Forumit Gruas me veprimtari, që kanë lënë mbresa në shoqëri.

- Zv. Kryetare e Klubit Letrare të Shkrimtarëve Poetëve dhe Artistëve të

Veriut ku vepron aktualisht.

- Anëtare Nderi e Shoqatës Kulturore "Jehona Shqiptare".

- Sekretare e Parlamentit Shpirtëror Shqiptar me qendër në Tiranë.

- Anëtare e Kryesisë së "Shoqata e Paftimit Mbarëkombëtar".

- Drejtore e Departamentit "Gazeta e Alpeve" për Qarkun Lezhë.

Tashmë, e dëshmuar në art: Në veçanti në lëmin e Poezisë, Kritikës e Analizës, si dhe Studimit Letrar, gjithashtu dhe të Monografisë Historike apo Etnosit Kulturor, është Editore e Revistës "PENA E ARTË" dhe ka nxjerrë gjashtë numrat e saj të parë.

## Librat e Publikuar:

1. "Memoaret e shpirtit",
2. "Profecia e mëkatit",
3. "Kur të jesh mërziur",
4. "Kambanat bien",
5. "Puhizat e mëngjesit",
6. "Frymëzimi je ti",
7. "Imazhet e stinës",
8. "Qiejt e ëndrrave",
9. "Qiejt e shpirtit",
10. "Dhimbje largësish",
11. "Eklipsi i stinëve",
12. POEZIA E AJGERAJT NË DIOPTRINË E ANALIZËS DHE TË KRITIKËS LETRARE - Studim letrar
13. DIVERSITETI I PENËS SË AJGERAJT NËN DIOPTRINË E ANALIZËS DHE TË KRITIKËS LETRARE - Studim letrar
14. METAFORA E MALLIT (Përzgjedhje poetike nga poezia e Ajgerajt)
15. POETI I METAFORAVE – Studim letrar
16. ROMANI I AJGERAJT NËN OPTIKËN E ANALIZËS DHE TË KRITIKËS LETRARE - Studim letrar
17. VLERËSIME KRITIKE DHE ANALIZA LETRARE – Kritikë letrare
18. POETIKA IME NËN THJERREZËN E VLERËSIMEVE KRITIKE DHE ANALIZËS LETRARE- Kritikë letrare
19. Poezi: "Hijenat e erërave", Prizren, 2021
20. DIVERSITETI I ARTIT NËN THJERREZËN E VLERËSIMEVE KRITIKE DHE ANALIZËS LETRARE - Kritikë letrare
- ANTOLOGJI:
21. KODI I MALEVE, ARTIZANATET DHE VESHJET POPULLORE TË BUGJONIT DHE ZONAVE PËRRETH Etnos
22. FESTAT, RITET E JETËS DHE ETNOSI BUGJONAS E ZONAVE PËRRETH Etnos
23. ETNIA IME NË VARGJE Poezi
24. PARATHËNJE, STUDIME



# MËSIMET DHE PËSIMET E SALI MANIT!

MUZIKA ËSHTË LAJMËTARE E GËZIMIT, AJO SI ASKUSH LARGON MËRZINË LARTËSON DHE TË NGROHË SHPIRTIN.

Sali Mani, ishte një talent i lindur në kohën dhe vendin e duhur, punoi për kohën dhe koha e ngjiti në maja e folkut tonë Sali Mani i dha gjithçka çiftelisë dhe mori gjithçka prej saj si rapsod i kombit. Ai qe reformatori dhe politizuesi më i madh çiftelisë. Politika i dha mikrofonin, kurse zëri tij kumbues ngrohu miliona zemra ndaj dhe u adhuroa me shumë endje. Epika historike, patriotike të majave të Sali Manit hyri në të gjitha vatrat shqiptare. Dihet shumë mirë se kush ia hapi rrugën të dilte nga oazi krahinorë dhe i lumtë Saliut, që e përçoj më aq pasion e mjeshtëri.

As kaq kurajo se këmi?

Robër dje e robër sot! Po vijam kështu robër do të jemi edhe nesër. Sali Mani ishte më shumë poet se rapsod, rrjedhimisht këngët e tij janë të gjitha poezi dhe tekste të nivelit 9-të e më shumë 10-të, prandaj nuk ka as një rendësi konteksti politik apo ideologjik. "Në Kangë ka rendësi harmonia, por nuk asht vetëm kjo, rendësi të madhe kanë fjalët se këto përcjellin modelin tuaj i dhanë do jetë entuziazëm e ndjesi."

Kënga fluturon si shigjetë hapësirave të pa anë ndërsa poezia e shkruar është e dënuar të lypsi lexuesin derë më derë dhe të durojë mbjlljen e tyre kur nuk të qas njeri. Censurimi dhe korrektimi i disa teksteve nga origjinali sot është cenim i autencitetit artistik. Ajo kohë nxori Sali Manin, Dervish Shaqen, Tomë Nikollën, Ndue Shytin, Asiz Ndreun, Mehil Çunin, Qerim Sulën, Fatime Sokolin, Drande Gegën Lirie Rashën, Vitore Rushen, Grupin e Mirditës, të Hasit e të tjerë. Ajo kohë ka vulën e vet ndaj nuk mund rikthehet as të censurohet. Deri kurë do të vijojmë me herezi butaforike, politike mesjetare e mohimit të çdo gjeje të socializmit?


Sali Malësia ishte zotërues fuqi plotë i skenës, një zë i kadiftë, por jo vokalisti më i mirë i çiftelisë. Tekstet e sotme mjeranë, përpara vegimeve poetike të Sali Manit ngjajnë si lakuriqi i natës në dritë. Koha imponoi babait të çiftelisë së temperuar të anashkalonte disa tematika të mirëfillta të etnosit tonë të vjetër, por ai qe snajper i aktualitetit dhe temave historike të nyjës Kosovë-Shqipëri. Kush nuk do ta dëshiron te atë ekzekulivitet që pati ai dhe e justifikoj plotësisht. Sali Mani nga përtej skenës u thotë kujdes rapsodëve të sotëm, nga pseudo rapsodët dhe tallavaja. Kujdes, ndajuni nga tekstet me tematikë fisnore, privatë dhe eposi i rremë.

Mjeshtri i vjetër u kujton rapsodëve se jo gjithkush që kapë çiftelinë në është rapsod, as jo çdokush që vargëzon bën një tekst që duhet kënduar. Pësimi i vetëm i Sali Manit është se, folklorin e politizoi jo pak, mësimi i tij i madh është se revolucionarizoi çiftelinë.

Të kënduarit pa as një filtër është vrasje e folklorit dhe shijeve të dëgjuesit. Muzika së pari është për tu dëgjuar pastaj për tu parë. Përuimi dokumentarit "Artisti që i dha shpirtin këngës" dhe librit "Mbrapa lash vargjet e mija" të Sali Manit përgjatë një dite të plotë dhe pjesëmarrja e gjerë e personaliteteve të kulturës, artit dhe politikës nga hapësira mbarë shqiptare tregoi se Sali Mani la pas një testament folklorik kombëtarë!

Faleminderit që na dhe!

PRELË MILANI



## ◀ E KRITIKA LETRARE 25. TI BUGJON BAJRAKU I THAÇIT

26. PENA E AJGERAJT NË LETËRSI-NË PËR FËMIJË, Kritikë

27. SFIDAT E ARTIT KRITIKËS, Kritikë Letrare

28. NJERIU KJO QËNJE E VËSHTIRË  
29. MADHËSHTIA E KA EMRIN NËNË

- Antologji: "NA BASHKOI POEZIA 7", Dibra ime, poezi, 2020.

- Revista: "METAFORA 20", Prizren, 2020.

- Revista: "METAFORA 21", Prizren, 2021.

- Antologji; "Ëndërr për një botë", botoi; Biblioteka Ndërkomunale e Prizrenit, Prizren, 2021.

- Antologji: ORA E LIDHJES, (poezi nga konkursi letrar - 2021, Prizren, 2021-

- Antologji në gjuhën Suedeze, « Cikël

me poezi », Suedi, 2022

- Dy recensione tek Revista „Sharri“, maj 2021, Prishtinë

- Parapsikologji tek Revista "Sharri" Tetor 2023

### Editore e revistës, Pena e Artë:

- Revista PENA e ARTË 1, 2022 (Dhjetor)

- Revista PENA e ARTË 2, 2023 (Shkurt)

- Revista PENA e ARTË 3 2023 (Mars)

- Revista PENA e ARTË 4 2023 (Tetor)

- Revista PENA e ARTË 5 2024. (Shkurt)

- Revista PENA e ARTË 6 2024. (Qershor)

- Revista Metafora 22, 2023 (Janar)

- Revista Metafora 23 2023 (Qershor)

- Revista Metafora 30. 2024. (Janar)

- Revista Metafora 31. 2024. (Prill)

- Antologji "FJALË TË ARTA MBI SHKELZEN" 2023 Qershor

- Antologji në gjuhën Suedeze, Cikël me Poezi 2023 (Maj).

- Bashkë Editore e Revistës: "ROZAF", Shkodër, Numri 1, (Prill) 2023

- Bashkë Editore e Revistës: ROZAF, Shkodër Numri 2, (Mars) 2024

- Antologji DRITA IME Akademia "Trici. al.), Qershor 2024

- SINDH COURIER - PAKISTAN and MEBUSSINESS LIFE - EGJYPT, Korrik 2024, Editor Nasir Aijaz

- Revista ATUNIS, në Belgjikë Editor Agron Shele, Korrik 2024

- Rivista MIRIAD, ANGELA KOSTA, Direttore Esecutivo Korrik 2024

- Revista Letrare në dygjuhësh arabisht - anglisht Barcelona Literary Magazine në SPANJË, Korrik 2024

- Revista Letrare në gjermanisht Raven Cage Editor Jerry Langdon Korrik

2024.

- Revista Miriade Nr. 2 Itali, Angela Kosta 8 Shtator 2024

- Antologji III "Burim Shpirti" Lulu.com, 22 Shtator 2024

2024.

- Revista Miriade Nr. 2 Itali, Angela Kosta 8 Shtator 2024

- Antologji III "Burim Shpirti" Lulu.com, 22 Shtator 2024

Zonjë Prenda ka shkruar e botuar një numër të konsiderueshëm me parathënie e recensione për libra e autorë të ndryshëm në troje kombëtare.

Uroj, që Pena e saj, ashtu siç ka filluar vullshëm, të rrjedhë në vijimësi, me fjalë e bukur shqipe, me të cilat do të shijojnë e frymëzohen brezat e së ardhmes!

Me respekt dhe konsideratë të veçantë, idealisht dhe shqiptarisht:

**Zekirija Idrizi Shkup,  
Berlin - Shkrimtar**

## \*\*\* Poezi nga Kumrie Avdyl Shala \*\*\* Poezi nga Kumrie Avdyl Shala \*\*\*

## POEMË PËR VËLLAIN TIM DËSHMOR

Sa e rëndë është dhimbja e shpirtit,  
Të tjerët vështirë e kuptojnë,  
Sa trishtuese është kur të tjerët me çudi shikojnë,  
Shikim i bëjnë vetëflijimit,  
Kurse për vete këndojnë këngët e kryetrimt!

Sa e lumtur do të isha sikur edhe unë të isha me ty,  
Të festojmë 22 korrikun, vëlla, ne të dy,  
Së bashku në përjetësi,  
Në vitin 1998 në Lagjen Dardania III,  
Demë, vëllai im, i biri i Avdylit, mbiemri Shalë  
Bellagji i Grabocit të Pejës.

Këto janë shënimet nga shërbimet civile për ty,  
Por kjo nuk ka rëndësi,  
Ti ke dy emra:  
ÇLIRIMTAR dhe DËSHMOR  
LIRINË kurorë.

U flijove, vëlla, që të jetojmë ne në liri,  
Kurse ti jeton në përjetësi,  
Jetën së kurseve për pavarësi,  
Shtetin shumë e dëshirove,  
Pa fije frike rininë ia dhurove.

Fjalët tua më tingëllojnë dhe sot,  
Sa kjo dhembje që dhe më dhemb për mot:  
S'ka çka më bën armiku,  
Plumbin e ha me dhëmbë!

E tash, dëshmori im!  
Ti atje nuk e di,  
Kanë dalë do çlirimtarë,  
Komandantë e pashallarë,

Të hipur mbi lapidarë,  
Krejt të veshur me ar,  
Dëshmorët i futin nën hije,  
Me qëllim e me vetëdije.

Ne krenohemi me ty,  
Me shokët tu heroikë,  
Trima e stoikë.

Vëlla, o Demush,  
Si ti nuk ishte kush,  
Shokët s'i tradhtove,  
Në ballë të kolonës qëndrove,  
Sa shpejt bombën aktivizove,  
E shkrepe mbi punktun serb,  
Aty në Dardani III,  
Re i ri edhe ti, Demush,  
Si ti kurrkush,  
Mic Sokol e Vojo Kush,  
Legjenda jote e re,  
Historisë tash po ec,  
Afër fshatit Gorazhdec,  
Mbushur me serbë e shkina plaka,  
Dhe tash po u del flaka,  
Ëndërrojnë bomba në dorë,  
Trima shqiptarë me orë.

Demë, o vëlla Demush!  
Si ti kurrkush,  
Atë natë shpëtove dyzetepesë veta,  
Ushtarë e civilë,  
E trupin tënd të njomë ia fale tokës sonë,  
Lajmi mori dheun:  
Nje djalë Belleje,

Nga derë e Ali Dushit,  
Nip i Marash Palit,  
Shaljani i Avdyl Shalës,  
Në betejë frontale me bombë në dorë,  
Ra dëshmor,  
U ngrit në lapidar,  
Vëllai im ushtar,  
Sa vëlla, sa çlirimtar,  
Me bombë në dorë,  
Kishte dhe ka orë.

Si ata shtatë Shaljanët e Dukagjinit, dikur,  
Po sa rrebeshe uji kaluan nën urë,  
Demë Demushi sot është i teti Shaljan,  
Sa heronj që ishin, po aq dhe sot janë,  
Por, historia e lirisë këtu nuk përfundon,  
Atdheu gjithmonë dëshmorë sfidon.

## PENDOHU

Vallë, a ke ti ndërgjegjeje apo je duke pritur se:  
ajo vjen e të vret me plumb?!  
A ndjen qetësi kur dikë e lëndon,  
Ndoshta një ditë do të pendohesh.

Pse aq shumë shfaq "dashuri",  
që ta ushqesh sëmundjen tënde egoiste  
E çdo ditë nxjerr nga goja helm e vrerë  
Dhe flakë kuçedre

A, kështu e ndihmon shokun!  
Apo i gëzohesh fyerjes, duke u fshehur  
Pas patriotizmit të mykur e te errët  
Që je duke ua trasuar pasardhësve tu!

Pse, se pranove kurrë  
Se ishe helm për gjelbërimin e natyrës,  
Që shpresën ua ndale!  
Me flaken tënde dogje çdo pyll rreth teje.

Askund nuk le nam as nishan për kokë as mote.  
Kur filloj shumimi i bimëzimit të njomë,  
Ti e dogje, duke u krenuar  
që vetëm ti di ta mbrosh atdheun.

Vallë a gëzohesh që sythet ua thave në degë  
Mu atëherë kur filluan jetën e re  
Mu atëherë kur putheshin rrezet e diellit.

Pse ende krenohesh  
me atë ndërgjegjejen tënde të krimbur!  
Harrove se shtatit ia ndalove rritën  
Duke marrë pamjen e një plaku njëqindvjeçar.

Vallë pse u tërhoqe  
dhe e le çdo gjë të varur në qafë t' djallit,  
duke heshtur kinse je patrioti i vetshtetit tonë.

## EJA TË PUSHOJ NË GJOKSIN TËND

Eja vetëm njëherë të pushoi në gjoksin tënd,  
Dua të qaj me dënes,  
Se pak nga pak për ty po vdes.

Asnjë ditë nga mendja nuk të largoj,  
ditë e natë në ty ëndërroj!  
Ku je sonte shpirtë,  
sa shumë kam mall  
Zemra digjet flakë,  
pranë teje që s'jam.

Dua të dehëm me aromën tënde,

Me afsh të puthë e të ledhatoj,  
Ku je sonte së po të prese!  
Zemra po qanë me dënes!  
Me thuaj pra, deri kur të pres,  
që t' ndjejë aromën tënde,  
E mos te vdes në heshtje pa prezencën tënde!

Oh, ç'ndjenje me ka kapluar të të kem pranë,  
Të të puthë me afsh,  
o shpirt, o xhan!  
Kur sytë ti shikoj, ndjej afshin për brenda.  
Te dua o xhan për ty me plasi zemra.

Nuk jam poete të të thurë vargje dashurie,  
Por jam ajo goca që për ty,  
Si qiri po shkrihem!  
S'dua premtime mos më premtto,  
nuk dua dhuratë,  
mos më dhuro.  
Vetëm diçka dua nga ti, dashurinë ma kthe, me dashuri.

Mjafton vetëm njëherë të kam t' shkretën mundësi,  
Të të shkrihem në gjirin tënd e struktur të rri.  
E di se ti nuk me beson,  
Sa po me djegë xhani,  
Sa shumë po vuaj,  
sa shumë për ty më merre malli !

## DUKAGJIN E SHKODËR

Prej Rozafës së Shkodrës një zë dëgjoj  
Ku jeee patriote ai zë jehojë,  
Brof, ktheva kokën,  
pash një pëllumb shtegtar,  
fluturoj në qellin mbi trojet e t' pareve tanë.

Mbi Liqe të Shkodrës ai fluturonte  
Lumin e Shalës nga kullat e shikonte,  
Me kërshtëri e shikoja se si i vëzhgonte,  
sikur majat e shkrepeve donte t'i bashkonte.

Ti Kështjella e Shkodrës me rri si zonjë e rëndë,  
çdo gur i murosur,  
histori të dhimbshme në vete e mbanë.

Çdo cep i Kështjellës flet për trimëri,  
bijtë e bija tona u flajuan për lirë,  
që Atdheu i ynë mos të mbeste n' robëri.

Vilajeti i Shkodrës, ishte me zë,  
Nuk lejojë t' sundohej nga turk e as shkja.  
Rreth e përçark djemtë të Dukagjinit,  
Krahina e Shalës valon n' Kull t' Ngujimit.  
Bashkë më Heronjtë e Vigut mbrojtët kufirin.

Ato rrugë gjarpërorë me shkrepa e lugina  
me lisa të gjatë e me çetina,  
Male të thepisura e me bimësi  
Ti, Dukagjin i lashtë përplot me histori.

Pse keni me ndie për djemtë shaljan,  
Luftëtar ishin edhe do jenë,  
Se, din të drejtojnë gjithë atë anë  
E fjalës leqe kurrë nuk i bëjnë.

Djemtë e Dukagjini janë si luaj  
Sa here i kërkon atdheu  
në mbrojtje do t'i janë,  
disa me pushkë e disa me penë,  
nuk lejojnë t'ua sundojnë Atdheun.

## REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj  
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,  
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,  
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,  
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi botimin  
**NIKOLIN GJELOSHI,**  
ITALI

